

RAPORTI VJETOR



2017

P Ë R M B A J T J A

• Mesazhi i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës.....	3
• Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm	4
• Vizioni, Misioni, Vlerat e shoqërisë.....	5
• Sruktura qeverisëse.....	6
• Eurosigt nëpërmjet shifrave	9
• Momente të rëndësishme	11
• Ne jemi Eurosigt	12
• Përgjegjësia sociale	21
• Promovimi i vlerave të Eurosigt, çmime, vlerësime.....	24
• Pjesëmarrjet e Eurosigt në kapitalin e shoqërive të tjera	27
• Lista e aksionarëve të Eurosigt me pjesëmarrje influencuese të kapitalit.....	27
• Lista e administratorëve të Eurosigt	27
• Monitorimi, administrimi dhe kontrolli i riskut që ndërmerr Eurosigt	28
• Raporti i Auditimit të Brendshëm	30
• Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, treguesi i likuiditetit dhe treguesi i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike	40
• Objektivat për vitin 2018	40
• Opinioni i Shoqërisë Audituese dhe Pasqyrat Financiare sipas SNRF	41

MESAZHI I KRYETARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS



Vasil PILO
Kryetar i Këshillit
Mbikëqyrës

*Të nderuar aksionerë,
Të nderuar klientë,
Të nderuar partnerë, miq e bashkëpunëtorë,
Të nderuar punonjës,*

Është kënaqësi që, nëpërmjet këtij mesazhi përshëndetjeje, të ndaj përzemërsisht me Ju suksesin e arritur nga Eurosig, gjatë vitit 2017.

Në sajë të planifikimeve strategjike efektive që zbatuam, ne ia dolëm që të kapërcejmë me sukses sfidat e tregut të sigurimeve. Në krahasim me vitin 2016, u rritëm me 1,02%, duke u renditur në vendin e dytë në shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, me 15,23% të tregut. Së bashku me INSIG-un mbulojmë 22,51% të tregut.

Rezultatet financiare në rritje gjatë viteve të fundit, investimi në blerjen e shoqërive të sigurimeve ndikuan në konsolidimin e vazhdueshëm të pozicionit të Eurosig në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon. Por sfidat janë në rritje, veçanërisht në kushtet e ndikimeve jo të favorshme politike, ekonomike dhe sociale në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, ku ne operojmë.

Në periudhën shtator - dhjetor 2017, në koherencë me kërkesat e akteve ligjore dhe rregullatore hodhëm hapat e duhur për organizimin dhe funksionimin e Grupit Eurosig. Korniza qeverisëse e miratuar na jep garanci për realizimin me sukses të objektivave që kemi përcaktuar në nivel shoqërie dhe grupi.

Standardet e larta të arritura nga Eurosig janë provë e bashkëpunimit të suksesshëm që kemi përforcuar në vite me klientët dhe partnerët tanë, si dhe rezultat i përkushtimit maksimal të Menaxhimit të Lartë, Menaxhimit Operacional dhe të gjithë stafit të Eurosig.

Dëshiroj të theksoj se gjatë katërmbëdhjetë viteve të veprimtarisë së Eurosig, kemi treguar se jemi gjithmonë me vizion, kemi identifikuar vazhdimisht mundësi të reja, duke ecur me kërkesat e tregut dhe nevojat e klientëve. Hartimi dhe ofrimi i produkteve novatore, përkujdesja maksimale ndaj klientit, pagesa në kohë e dëmeve ka përmbushur synimin tonë që t'i bëjmë klientët tanë të ndjehen të qetë dhe të sigurtë, përtej marrëdhënies formale të biznesit.

Falënderim i veçantë për suksesin tonë u takon aksionarëve, klientëve dhe partnerëve të biznesit, për besimin që na kanë dhënë ndër vite.

Besimplotë në mbështetjen Tuaj të çmuar, Ju ftojme në rrugëtimin tonë të përbashkët gjatë vitit 2018.

Vasil PILO
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM



Dr. Xhevdet KOPANI
Drejtore i Përgjithshëm

Të nderuar lexues,

Viti 2017 për Shoqërinë Eurosig ishte një vit i progresit dhe konsolidimit të mëtejshëm të treguesve dhe performancës së saj, rritje e cila ka arritur e progresuar vit pas viti.

Shoqëria “Eurosig” është në vendin e dytë në industrinë e sigurimit me një diferencë të ndjeshme nga vendi i tretë, tregues i arritur tashmë në disa vite.

Shoqëria EUROSIG, gjatë vitit 2017, dëshmoj se mbetet shoqëri e fokusuar tek klienti, shërbimi ndaj tyre, dëmshpërblimi real dhe në kohë i dëmeve. Vlera e dëmeve të paguara është tregues domethënës dhe në rritje nga njeri vit në tjetrin. Kjo përkujdesje ndaj klientëve është ajo çka na diferencon neve nga të tjerët.

Treguesit e arritur janë fryt i punës, përkushtimit, profesionalizmit të të gjithë punonjësve, agjentëve, ndërmjetësve, të bashkëpunëtorëve të mij, të cilët me këtë rast i falënderoj për gjithçka kanë bërë gjatë këtij viti për përmbushjen e objektivave strategjike dhe ato vjetore.

Gjithashtu, këta tregues pozitiv janë realizuar falë dhe kujdesit dhe mbështetjes së aksionarëve dhe Këshillit Mbikëqyrës.


Në vitin 2017, ne bashkëpunuam me qindra e mijëra klientë, të cilët i falënderoj për besimin e treguar dhe njëkohësisht i garantojmë në përkushtimin dhe devotshmërinë tonë për t’u shërbyer në çdo moment, për t’u qëndruar pranë në rast aksidenti dhe për të bërë të gjitha përpjekjet për një shpërblim të shpejtë dhe të drejtë.

Njëkohësisht, falënderojmë partnerët tanë ndërkombëtar, risigurues, brokera etj., të cilët dëshmuar partneritet, besnikëri dhe besueshmëri ndaj nesh.

Qëllimi i Shoqërisë Eurosig ka qenë dhe mbetet puna në ekip, menaxhimi efikas, përgjegjshmëria e lartë në shërbimin ndaj klientit. Kjo do të jetë në themel të punës tonë edhe gjatë vitit 2018.

Objektivat për vitin 2018 janë ambicioze, sfidat janë të mëdha, por dhe të arritshme. Ne synojmë të ofrojmë shërbime më të shpejta e cilësore për klientët, duke realizuar procesin e dixhitalizimit të shërbimeve, ofrimit online të tyre, reduktimin e kohës jo produktive të klientëve për marrjen e shërbimit dhe të dëmshpërblimit. Aplikimi online i prerjes së policave, i kërkesës për dëmshpërblim janë sfida që do të përmbushen brenda vitit 2018.

Miqësisht
Dr. Xhevdet KOPANI



VIZIONI, MISIONI, VLERAT E EUROSIG



VIZIONI

Të qenit lider në fushën e sigurimeve, bazuar në standarde europiane, që orientohet nga përforma e shtuar, në përputhje me kërkesat e palëve të interesuara, duke u mbështetur në filozofinë e vlerave, profesionalizmit, bazueshmërisë ligjore, reflektimit ndaj kërkesave të klientit dhe fokusimit tek ai.

MISIONI

- a) të sigurojmë produkte, shërbime dhe aktivitete ndaj klientëve, duke përsosur shërbimin, cilësinë, profesionalizmin, etikën, duke funksionuar si një shoqëri financiare, me qëllim optimizimin e kërkesave të klientëve, rritjen e kapitalit financiar, rritjen e vlerës së aksioneve, duke i siguruar klientët për mbështetje në çdo kohë, për kompensim të plotë dhe të drejtë për dëmet;
- b) të ofrojmë shërbime sipas standardeve europiane, duke konsoliduar pozicionin e saj dhe duke garantuar emër e reputacion tek partnerët rajonalë, europianë e më gjerë;
- c) të marrim reagime (*feedback*) nga klientët me forma e metoda bashkëkohore dhe reflektim të tyre, për të përmirësuar shërbimin.

VLERAT E SHOQËRISË

Shoqëria Eurosigt, tashmë ka një emër në industrinë e sigurimeve dhe përbën një

vlerë të shtuar në këtë industri. Përvoja 14 vjeçare në fushën e sigurimeve, zgjerimi në tregun e sigurimeve në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, jo vetëm i ka konsoliduar këto vlera, por i ka bërë të qëndrueshme dhe që ndikojnë drejtpërdrejtë në vlerën e shoqërisë.

Filozofia e Eurosigtut për orientimin ndaj klientit, përbën një qasje që mbart vlera për tani dhe në të ardhmen.

Shtirja e Eurosigtut në të gjithë vendin dhe burimet njerëzore të punësuar shtojnë vlerat dhe rritin mundësitë për suksese në vijimësi. Asetet humane po konsolidohen, duke i shërbyer sfidave të së ardhmes.

Pozicionimi dhe besueshmëria e arritur në tregun e sigurimeve me një rritje të ndjeshme, relativisht të shpejtë, përmirësimi i imazhit të Eurosigtut, zgjerimi i rrjetit të shitjes së produkteve, investimet e bëra në teknologjinë e informacionit, kanë ardhur si rezultat i një drejtimi të suksesshëm menaxherial, pune të vazhdueshme nga një staf i kualifikuar, dinamik dhe profesionist i vërtetë në fushat që veprojnë.

Drejtnesit dhe punonjësit e Eurosigtut janë të vëmendshëm ndaj kërkesave të klientit, duke ju ofruar atyre produktet më favorite dhe këshillat më të mira.

Performimi i Eurosigt në raport me industrinë dhe historinë e saj, me rritje dhe konsolidim në tregun e sigurimeve, përbëjnë një vlerë që do të ndikojë pozitivisht në ecurinë e shoqërisë në të ardhmen.

STRUKTURA QEVERISËSE



BURIMET NJERËZORE

Duke i konsideruar burimet njerëzore si një faktor të rëndësishëm dhe kapitalin intelektual për rritjen e biznesit tonë, Eurosig investon sistematikisht në përzgjedhjen, trajnimin, vlerësimin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e punonjësve. Aktualisht Eurosig është e shtrirë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë me degë, agjenci dhe pika shitjeje e përfaqësimi. Shoqëri sigurimesh të Grupit Eurosig performojnë me sukses dhe në Kosovë e Maqedoninë e Veriut.

Në Eurosig, ne besojmë që rruga më e shpejtë për rritje është ekspozimi drejt sfidave të reja. Një shembull i mirë i këtij promovimi nga brenda është zhvillimi i eksperiencës sonë. Punonjësit e kualifikuar, të cilët po rriten në shkollat

e Eurosig dhe kanë treguar një performancë të vazhdueshme, janë aktualisht menaxherë të strukturave qendrore dhe vendore në të gjithë Shqipërinë.

Suksesi profesional i punonjësve të Eurosig është i garantuar edhe përmes trajnimeve të vazhdueshme të menaxherëve dhe punonjësve të strukturave qendrore dhe vendore. Gjatë vitit 2017, janë trajnuar në mënyrë të përqendruar dhjetëra punonjës, drejtues dhe specialistë të shitjes së degëve dhe agjencive, për zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të Eurosig. Ndërkohë që trajnime më specifike u janë ofruar individualisht punonjësve të rinj të rekrutuar, si dhe atyre që kalojnë në pozicione të reja pune.



QEVERISJA E EUROSIG



Qeverisja e Eurosigg realizohet nga:

Asambleja e Aksionarëve Aksionarët e shoqërisë Eurosigg janë:	
Z. Kadri MORINAJ	70,741 pikë përqindje pjesëmarrje.
Z. Xhevdet MORINA	19,225 pikë përqindje pjesëmarrje.
EURO-ALBA-EA	9,693 pikë përqindje pjesëmarrje.
Z. Ylli MERKAJ	0,341 pikë përqindje pjesëmarrje.

KËSHILLI MBIKËQYRËS

Këshilli Mbikëqyrës, si organ qeverisës i Shoqërisë, mbikëqyr punën menaxheriale dhe merr vendime për probleme të rëndësishme të nivelit strategjik, sipas përcaktimeve të akteve ligjore, nënligjore, rregullatore dhe akteve të brendshme të Eurosigg.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë:

Z. Vasil PILO	- Kryetar
Z. Rexhep MEIDANI	- Anëtar
Z. Skënder MADANI	- Anëtar

KOMITETI I AUDITIMIT DHE MENAXHIMIT TË RISKUT

Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut ndihmon Këshillin Mbikëqyrës në përmbushjen e funksioneve të veta mbikëqyrëse kundrejt aksionarëve dhe palëve të interesit; shqyrton dhe vlerëson rregullisht politikat, strategjitë, kufijtë dhe proceset që kanë të bëjnë me menaxhimin e riskut në shoqërinë e sigurimit, si dhe jep rekomandime për Këshillin Mbikëqyrës në lidhje me miratimin e tyre, apo çdo ndryshim të tyre që gjykohet i përshtatshëm.

Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut përbëhet nga:

Z. Halim BAKALLI, Ekspert Kontabël	- Kryetar
Znj. Elda LASHI	- Anëtar
Prof. As. Dr. Zef GJETA	- Anëtar



Në ushtrimin e detyrave funksionale dhe përgjegjësi, Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut mbështetet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.

Përveç Komitetit të Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, në Eurosig funksionojnë edhe Komiteti i Investimeve, Komiteti i Risigurimit, Komiteti i Vlerësimit të Dëmeve dhe Grupi për Menaxhimin Strategjik. Fushat e përgjegjësisë së tyre janë të përcaktuara në aktet e brendshme të Eurosig.

MENAXHIMI I LARTË

Menaxhimi i Lartë mbikëqyr dhe përgjigjet për menaxhimin e veprimtarive dhe performancën e të gjitha strukturave qendrore dhe vendore të Eurosig.

Menaxhimi i Lartë përbëhet nga:

Z. Xhevdet KOPANI	- Drejtor i Përgjithshëm
Znj. Anila IBRO	- Drejtor i Departamentit Ekonomik&Operacional
Zj. Akena MEMA	- Drejtor i Departamentit të Sigurimeve dhe Risigurimeve
Z. Qamil SADIKAJ	- Drejtor i Departamentit të Dëmeve

MENAXHIMI OPERACIONAL

Menaxhimi Operacional përbëhet nga drejtues të drejtorive, sektorëve, njësive të tjera strukturore qendrore dhe degëve vendore, menaxhon dhe përgjigjet për performancën e njësive strukturore të Eurosig.

EUROSIG NËPËRMJET SHIFRAVE



Shoqëria Eurosig për vitin 2017 ka performuar pozitivisht, duke treguar qëndrueshmëri, konsolidim dhe standarde të larta.

- ❖ Gjatë vitit 2017, krahasuar me vitin 2016, volumi i primeve të shkruara bruto pati një rritje me 1,02%. Renditemi në vendin e dytë në shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, me 15,23% të tregut
- ❖ Numri i dëmeve të paguara u rrit me 21% krahasuar me vitin 2016. Volumi i dëmeve të paguara është 565 208 000 lekë, ose 23,29% më shumë se në vitin 2016.
- ❖ Pesha specifike e volumit të sigurimeve vullnetare kundrejt totalit është 29,57%, duke u renditur në vendin e tretë.
- ❖ Volumi i primeve të shkruara bruto në Sigurimin Motorik është 2,33% më shumë se në vitin 2016. Vlera e dëmeve të paguara për Sigurimin Motorik është 31,35% më shumë se në vitin 2016.
- ❖ Volumi i primeve të shkruara bruto në Sigurimin nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e tjera në Pronë u rrit me 31% krahasuar me vitin 2016. Vlera e dëmeve të paguara për këto produkte u rrit më 319% krahasuar me vitin 2016.
- ❖ Pjesa e Eurosig ndaj totalit në Sigurimin e Aksidenteve dhe Shëndetit është 25,06%, duke u renditur në vendin e dytë. Vlera e dëmeve të paguara për Sigurimin e Aksidenteve dhe Shëndetit është 19,35% më shumë se në vitin 2016, duke u renditur në vendin e dytë.
- ❖ Volumi i primeve të shkruara bruto në Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim është 6,55% më shumë se në vitin 2016, duke u renditur në vendin e tretë.
- ❖ Në Sigurimin e Sëmundjeve renditemi në vendin e dytë me 31,7% të tregut të Jo-Jetës.

Të dhëna për Grupin Eurosig, për vitin 2017

Nr.	Emërtimi	Volumi i primeve të shkruara bruto, në Euro	Pesha specifike ndaj totalit, në %
1.	Eurosig - Shqipëri	16 925 300	36,85
2.	Eurosig - Kosovë	10 827 076	23,57
3.	Insig - Shqipëri	8 087 916	17,61
4.	Insig - Kosovë	5 630 073	12,26
5.	Eurosig – Maqedoni e Veriut	4 458 763	9,71
TOTALI		45 929 128	100



Tregu i sigurimeve sipas shteteve ku ushtron aktivitet Grupi Eurosig

Emërtimi	Volumi i Primeve të Shkruara Bruto për vitin 2017			
	Aktiviteti i Jo-Jetës	Aktiviteti i Jetës	Risigurimi	Gjithsej
Republika e Shqipërisë	111 251 608 Eur	8 987 066 Eur	609 670 Eur	120 848 344 Eur
Republika e Kosovës	84 919 344 Eur	2 528 177 Eur	-	87 447 521 Eur
Republika e Maqedonisë së Veriut	122 722 947 Eur	23 515 823 Eur	24 826 509 Eur	171 065 279 Eur
Gjithsej	318 893 899 Eur	35 031 066 Eur	25 436 179 Eur	379 361 144 Eur




MOMENTE TË RËNDËSISHME

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GRUPIT EUROSIG

ORGANIZIMI STRUKTUROR I GRUPIT EUROSIG

Sipas përcaktimeve në ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe në Rregulloren e AMF-së nr. 55, datë 26. 05. 2017, “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”, me vendim të Asamblesë së Aksionarëve nr. 15, datë 13. 11. 2017, u krijua Grupi

i Sigurimit Eurosig. Në përbërje të këtij Grupi janë: Eurosig Shqipëri, shoqëri mëmë; INSIG Shqipëri, Eurosig Kosovë dhe Eurosig Maqedoni, shoqëri të kontrolluara nga Eurosig Shqipëri; dhe Dega e INSIG Kosovë, si Degë e INSIG Shqipëri.



Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar aktet e brendshme të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e Grupit Eurosig, ku përmendim: vendimi nr. 17, datë 12. 12. 2017, “Për miratimin e organigramës dhe strukturës organi-

zative të Grupit Eurosig”; Rregulloren nr. 18, datë 12. 12. 2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Grupit Eurosig”; “Kodin e Sjelljes dhe Etikës në Grupin Eurosig” nr. 19, datë 12. 12. 2017.

NE JEMI EUROSIG



Shoqëria Aksionare Eurosrig është themeluar, më 16.07.2004, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, më 19.07.2004, me NUIS K41926801W. Drejtoria e Përgjithshme (struktura qendrore) e shoqërisë është në Tiranë, në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", Vila nr. 5, Tiranë.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet me ligjin nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe akte të tjera nënligjore dhe rregullaore të dala në zbatim të tij, si dhe mbikëqyrjet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Eurosrig udhëhiqet nga Statuti i Shoqërisë dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me Rregulloren e Brendshme "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shoqërisë Eurosrig sh.a." dhe një tërësi aktesh të brendshme.

Eurosrig, si shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë me 28 degë dhe mbi 230 agjenci dhe pika shitjeje e përfaqësimi. Aktualisht në Eurosrig janë të punësuar afro 300 punonjës në nivel qendror dhe vendor. Në Drejtorinë e Përgjithshme ushtrojnë veprimtarinë Departamenti i Sigurimeve dhe Risigurimeve, Departamenti Ekonomik dhe Operacional, Departamenti i Dëmeve, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, Drejtoria e Sigurimeve të Pronës, Përgjegjësitë & Garancive, Drejtoria e Administrimit të Shitjeve&Sigurimeve Motorrike, Drejtoria e Financë-Kontabilitetit & Analizës, Drejtoria e Shitjeve të Produkteve të Shëndetit, Drejtoria e Dëmeve Shëndetësore, Njësia e Auditimit të Brendshëm etj.

AKTIVITETET KRYESORE TË EUROSIG PËRFSHIJNË:

PRODUKTET E SIGURIMEVE VULLNETARE:

- Sigurimi i Aksidenteve Personale,
- Sigurimi i Shëndetit dhe Sëmundjeve,
- Sigurimi Kasko,
- Sigurimi i Pasurisë (nga zjarri dhe forcat e natyrës),
- Sigurimet ndaj Dëmtimeve dhe Humbjeve të Tjera të Pasurisë,
- Sigurimi i Garancisë,
- Sigurimi i Mallrave në Transport,
- Sigurimi i Përgjegjësisë të Anijeve dhe Mjeteve Lundruese,
- Sigurimi i Përgjegjësisë të Përgjithshme (të të gjitha llojeve),
- Sigurimi i Bankave BBB&ECC;

- Certifikata Motorrike Ndërkombëtare e Sigurimit – Kartoni Jeshil,
- Sigurimet Kufitare.

Zgjerimi i rrjetit të shitjes, pozicionimi në tregun e sigurimeve me një rritje të ndjeshme dhe relativisht të shpejtë ka ardhur si rezultat i një pune të vazhdueshme të një stafi të kualifikuar, dinamik dhe profesionist të vërtetë në fushat që veprojnë. Drejtuesit dhe punonjësit e Eurosrig janë të vëmendshëm ndaj kërkesave të klientit, duke ju ofruar atyre produktet më favorite dhe këshillat më të mira.

Eurosrig, në vitet e fundit, është klasifikuar si kompania me trendin më të lartë të rritjes në tregun e sigurimeve. Aktualisht, për veprimtarinë e sigurimit të Jojetës Eurosrig renditet në vendin e dytë, me 15,23% të tregut. Eurosrig ka rentabilitet shumë të mirë.

PRODUKTET E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM:

- Sigurimi i Detyrueshem Motorrik për Përgjegjësitë ndaj Palëve të Treta (DMTPL),

SHTRIRJA GJEOGRAFIKE



DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Rr. "Papa Gjon Pali II", Vila nr. 5, Tiranë, Shqipëri

Xhevdet KOPANI

Drejtor i Përgjithshëm

✉ xhkopani@eurosig.al

☎ +355 69 40 00 412

Anila IBRO

Drejtor

Departamenti Ekonomik & Operacional

✉ anibra@eurosig.al

☎ +355 69 20 58 675

Agena MEMA

Drejtor

Departamenti i Sigurimeve & Risigurimeve

✉ amema@eurosig.al

☎ +355 68 61 55 336

Qamil SADIKAJ

Drejtor

Departamenti i Dëmeve

✉ qsadikaj@eurosig.al

☎ +355 69 70 83 043

Krizelda THARTORI/ÇELA

Drejtor

Drejtoria Juridike

✉ kthartori@eurosig.al

☎ +355 69 40 95 541

Veli HAKLAJ

Drejtor

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut

✉ vhaklaj@eurosig.al

☎ +355 69 85 38 593

Albiola TAKO

Shef

Drejtoria e Sigurimeve të Pronës,
Përgjegjëse & Garancive

✉ atako@eurosig.al

☎ +355 69 98 57 821

Edmir DYMLEKU

Drejtor

Drejtoria e Shitjeve & Sigurimeve Motorike

✉ edymleku@eurosig.al

☎ +355 67 40 09 688

Drejtoria e Shitjeve të Shëndetit

✉ mlleshi@eurosig.al

☎ +355 69 70 74 522

✉ eqarri@eurosig.al

☎ +355 69 79 62 205

Besmira SINANAJ

Drejtor

Drejtoria e Dëmeve të Shëndetit

✉ bsinanaj@eurosig.al

☎ +355 69 70 92 854

Elda LASHI

Shef

Drejtoria e Financë-Kontabilitetit

✉ elashi@eurosig.al

☎ +355 69 37 72 964

Fatjon SAJA

Shef

Sektori i Teknologjisë së Informacionit

✉ fsaja@eurosig.al

☎ +355 69 40 95 540

Areta ÇUKO

Aktuari i Autorizuar

✉ acuko@eurosig.al

☎ +355 67 22 99 970

Sekretaria

✉ info@eurosig.al

☎ +355 (0) 42 238 999 / 899

+355 (0) 69 60 70 659

+355 (0) 42 223 841

DEGËT E EUROSIG

Dega Tirana 1

Kolë KUKAJ

Drejtör

✉ kkukaj@eurosig.al

☎ +355697431207 / +355(0)42272944

📍 Tiranë, Bulevardi “Bajram Curri”,
përballë Eksp. “Shqipëria Sot”

Dega Tirana 4

Edison ÇOLLAKU

Drejtör

✉ dega.tirane4@eurosig.al

☎ +355 69 20 00 263

📍 Tiranë, Rr. “Asim Vokshi”, përballë
shkollës “Harry Fultz”

Dega Tirana 2

Vladimir QILIMI

Drejtör

✉ dega.kamez@eurosig.al

☎ +355 (0) 69 20 70 672

📍 Kamëz, Bulevardi “Blu”

Dega Tirana 5

Jonilda PONARI

Përgjegjës Zyre

✉ jponari@eurosig.al

☎ +355 69 80 86 553

📍 Tiranë, Rruga “Stavro Vinjau”, Nr
34, përballë Ambasadës Amerikane

Dega Tirana 3

Sokol GASHI

Drejtör

✉ sgashi@eurosig.al

☎ +355 69 40 87 330

📍 Tiranë, Rr. e “Durrësit”, përballë
bllokut të ambasadave

Dega e Tropojës

Gazmend DOÇI

Përfaqësues

✉ dega.tropoje@eurosig.al

☎ +355 (0) 21 32 30 55

📍 Bajram Curri, Rr. “Azem Hajdari”

Dega Shkodër 1

Siruan LISHI

Drejtor

- ✉ dega.shkoder@eurosig.al
- ☎ +355 (0) 22 44 592
- 📍 Shkodër, Rr. "2 Prilli", pranë Poliklinikës Qendrore

Dega Shkodër 2

Gëzim ALIBALI

Drejtor

- ✉ dega.shkoder2@eurosig.al
- ☎ +355 694056455 / +355 672173111
- 📍 Shkodër, Lagjja "Vojo Kushi", Sheshi "Demokracia", para teatrit Migjeni

Dega e Lezhës

Marie NDOJ

Përgjegjës

- ✉ dega.lezhe@eurosig.al
- ☎ +355 (0) 21 54 917
- 📍 Lezhë, Lagjja Besëlidhja, P. 63

Dega e Laçit

- ✉ dega.lac@eurosig.al

- 📍 Laç, qendër

Dega Kukës 1 & Hasit

Shkëlzen MALAJ

Drejtor

- ✉ dega.kukes@eurosig.al
- ☎ +355 (0) 21 42 21 42
- 📍 Krumë, qendër

Dega Kukës 2

Petrit PEPOSHI

Përgjegjës

- ✉ dega.kukes2@eurosig.al
- ☎ +355 69 20 56 808
- 📍 Kukës, pranë stacionit KU-TR

Dega e Dibrës

Asqeri PEPA

Drejtor

- ✉ dega.peshkopi@eurosig.al
- ☎ +355 (0) 21 82 550
- 📍 Peshkopi, Sheshi "Bajram Curri"

Dega e Matit

Elison ÇUPI

Përfaqësues

- ✉ dega.mat@eurosig.al
- ☎ +355 69 20 80 038
- 📍 Burrel, Sheshi "Ahmet Zogu"

Dega Elbasan 1

Adil KABILA

Drejtor

- ✉ dega.elbasan@eurosig.al
- ☎ +355 69 20 70 328
- 📍 Elbasan, përballë Postës Qendrore

Dega Elbasan 2

Vladimir SULA

Drejtor

- ✉ dega.elbasan2@eurosig.al
- ☎ +355 69 20 35 463
- 📍 Elbasan, mbrapa Bashkisë

Dega e Durrësit

Enkelejda COPA
Drejtore

✉ dega.durres@eurosig.al
☎ +355 (0) 52 23 41 36
📍 Durrës, Rr. "Admiral Abdi Mati"

Dega e Lushnjës

Albert ÇELA
Drejtore

✉ dega.lushnje@eurosig.al
☎ +355 (0) 35 22 57 34
📍 Lushnje, Bulevardi kryesor, pranë BKT-së

Dega e Korçës

Zana MANÇE
Drejtore

✉ dega.korce@eurosig.al
☎ +355 (0) 82 24 80 62
📍 Korçë, Bulevardi "Gjergj Kastrioti"

Dega e Beratit

Bexhet ALIA
Drejtore

✉ dega.berat@eurosig.al
☎ +355 (0) 32 23 76 22
📍 Berat, Lagjja "30 Vjetori"

Dega e Pogradecit

Elona KATIRAJ
Drejtore

✉ dega.pogradec@eurosig.al
☎ +355 (0) 83 22 30 07
📍 Pogradec, Lagjja 2, Rr. "Reshit Çollaku"

Dega Vlorë 1

Fatmir HYSENI
Drejtore

✉ dega.vlore@eurosig.al
☎ +355 (0) 33 40 05 30
📍 Vlorë, Lagjja "Pavarësia"

Dega e Bilishtit

Perlat CANE
Përfaqësues

✉ dega.bilisht@eurosig.al
☎ +355 69 57 87 445
📍 Bilisht, qendër

Dega Vlorë 2

Besnik MERKAJ
Përgjegjës

✉ dega.vlore2@eurosig.al
☎ +355 69 20 68 484
📍 Vlorë, Pallati i Ri, pranë Xhamisë

Dega Fier 1&2

Rustem HOXHA
Drejtore

✉ dega.fier@eurosig.al
☎ +355 (0) 34 22 91 93
📍 Fier, Bulevardi "Jakov Xoxa"

Dega e Gjirokastrës

Zenel PETA
Drejtore

✉ dega.gjirokaster@eurosig.al
☎ +355 (0) 84 26 85 50
📍 Gjirokastrë, Ish-blloku i furrave

Dega Fier 3

Mariol KONGJINI
Përgjegjës

✉ mkongjini@eurosig.al
☎ +355692949939 / +355(0)34221666
📍 Fier, Lagjja "15 Tetori"

Dega e Sarandës

Thanas QIRJAQI
Përgjegjës

✉ dega.sarande@eurosig.al
☎ +355 (0) 85 22 29 59
📍 Sarandë, Rruga e Flamurit



KLIENTËT E EUROSIG



Klientët tanë vijnë nga fusha të ndryshme të industrisë dhe rajone në të gjithë Shqipërinë, përfshirë dhe klientë ndërkombëtarë.

Strukturat e Eurosigs janë të fokusuar në klientelën e produkteve motorrike, me agentë të përzgjedhur, dhe kërkojnë cilësi në ofrimin e shërbimit prej tyre, duke demonstruar aftësinë për të tërhequr klientelë të re dhe duke menaxhuar risqet në këtë nivel. Kemi orientuar politika për zgjerim në produktet e sigurimit vullnetar

të Pronës dhe Shëndetit, Sigurimit Kasko dhe Kartonit Jeshil. Klientela e bizneseve të vogla identifikohet nga ndërmjetësit dhe agentët e besueshëm. Risqet më të mëdha përzgjidhen nga ndërveprimi i ndërmjetësve dhe specialistëve të shoqërisë të marrjes në sigurim. Klientët janë kryesisht banues të qyteteve.

Sifida e Eurosigs në të ardhmen mbetet zgjerimi në të gjitha produktet e sigurimit vullnetar dhe rritja e klientelës në zonat rurale.



PARTNERËT E EUROSIG



KOMPANITË E RISIGURIMIT - GARANCI FINANCIARE DHE MBROJTJE PËR KLIENTIN

Detyrimet financiare ndaj klientëve garantohen jo vetëm nga kapacitetet tona teknike dhe financiare, por dhe nga tregu financiar ndërkombëtar. Pjesëmarrësit në kontratat e risigurimit që lidh Eurosiga janë shoqëri risigurimi që përmbushin standardet ndërkombëtare të pagesës së dëmeve dhe stabilitetit financiar, të listuara në bazën e vlerësimeve ndërkombëtare, në përputhshmëri dhe në zbatim të kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të Eurosiga.

Shoqëria Eurosiga ka investuar një kosto relativisht të lartë për risigurimet me kompani risigurimi prestigjioze, si Hannover Re, Polish Re, Trust Re, Generali Group, Partner Re, Scor Re, VIG Re për të garantuar financiarisht detyrimet e mundshme dhe përgjegjësitë ndaj klientëve, si në risqet e sigurimit të pronës ashtu dhe në ato të sigurimeve motorrike dhe të përgjegjësiave. Grupi Eurosiga ka ruajtur prej disa vitesh dhe ka

zgjerruar bashkëpunimin edhe me risigures të tjerë, si Munich Re, Transatlantic Re, Atradius Re, Sava Re, Aspen Re dhe Swiss Re. Ne gjithashtu zhvillojmë marrëdhënie bashkëpunimi për risqet fakultative edhe me kompani të tjera risigures, gjithnjë duke u mbështetur në kriterin e vlerësimit financiar si dhe standardin e bashkëpunimit.

Marrëveshjet e Risigurimit të Pronës dhe Sigurimit të Detyrueshëm për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta, përveç garancisë financiare në pagesat e dëmeve të mëdha, kanë krijuar një fleksibilitet dhe cilësi të veçantë shërbimi ndaj klientëve.

Shoqëria Eurosiga ka bashkëpunim edhe me broker risigurimesh, me të vetmin qëllim: plotësimin e kushteve teknike sa më të përshtatshme dhe profesionale. Brokerët e risigurimit që ne bashkëpunojmë janë: Marsh (brokeri më i madh në botë), AON (brokeri i dytë më i madh në botë), WILLIS, JLT Re, MAI Broker etj.



VLERËSIME PËR PARTNERËT E EUROSIG



HANNOVER RE

Agjencitë e vlerësimit më të rëndësishme në industrinë e sigurimeve i kanë dhënë kompanisë së sigurimeve Hannover Re vlerësime shumë të forta për fuqinë financiare. Hannover Re, me një volum primesh bruto prej rreth 17,79 miliardë Euro për vitin 2017, është kompania e tretë risiguresuese më e madhe në botë. E themeluar në 1966 dhe me një staf prej 3 300 punonjësish, kjo kompani kryen aktivitetet në të gjitha linjat e Risigurimit të Jo-Jetës, Jetës dhe Shëndetit, duke qenë e pranishme në të gjitha kontinentet.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	A+	Superior
S&P	AA-	Very strong



POLISH RE

Shoqëria e Risigurimit Polish Re (Polskie Towarzystwo Reasekuracji) është e vetmja kompani në Poloni e specializuar në mënyrë rigoroze në biznesin e Risigurimit, në ofrimin e sigurimit të kompanive të sigurimit duke marrë përsipër pjesën e të ardhurave të tyre, primet e sigurimit në këmbim për pjesëmarrjen e mëvonshme në mbulimin e dëmeve. Kjo kompani ka hyrë në tregun e Risigurimit që nga shtatori 1996. Kompania operon në 40 vende, me mbi 200 klientë. Polish Re është një risiguresues lider dhe ka fituar besimin e klientëve në të gjitha shtetet e Europës Qendrore dhe Lindore.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	A-	Stable



TRUST RE

Shoqëria e risigurimit Trust Re në vitet e fundit ka shtuar prezencën e saj në shtetet e Europës Jugore dhe Juglindore duke qenë një partner i rëndësishëm edhe për Grupin Eurosigs. Trust Re ka një

kapital të autorizuar prej 500 milionë US\$ dhe kapital të paguar prej 250 milionë US\$, kurse volumi i primeve bruto për vitin 2016 ishte 481,7 milionë US\$. Shoqëria e Risigurimit Trust Re operon prej 25 vitesh në tregun e Risigurimeve duke mbuluar të gjitha linjat e biznesit me një orientim drejt linjave të reja të biznesit dhe inovacionit.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	A-	Excellent
S&P	A-	Stable



GENERALI GROUP

Grupi “Generali” është një nga lojtarët më të rëndësishëm në tregun e sigurimit global dhe financiar. E themeluar që në vitin 1831, në Trieste, karakterizohet që nga fillimi me një opinion të fortë ndërkombëtar dhe tani është e pranishme në më shumë se 60 vende të botës. “Generali” ka konsoliduar pozicionin e tij në mesin e botës së operatorëve kryesor të sigurimit, me aksione të ndjeshme në treg në Evropën Perëndimore - zona e saj kryesore e veprimtarisë - dhe veçanërisht në Gjermani, Francë, Austri, Spanjë dhe Zvicër. Me kapital të paguar prej 1,56 miliardë Euro dhe volumin e Primeve Bruto prej 68,54 miliardë Euro per vitin 2017, Grupi “Generali” klasifikohet në listën e 25 Risiguruesve më të mëdhenj në botë.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	A	Stable
Fitch	A-	Stable

VLERËSIMI I SHOQËRIVE TË TJERA RISIGURUESE

REINSURANCE COMPANY	RATE	
	S&P	A.M. BEST
PARTNER RE ZVICËR	A+	A
SCOR GLOBAL P&C DEUTSCHLAND	AA-	A+
SWISS RE	AA-	A+
R+V GERMANY	AA-	NR
VIG RE, CZECH REPUBLIC	A+	NR
ASPEN RE UK PER ZURICH BRANCH	A	A
GIC	NR	A-
NEW RE	AA-	A+

PËRGJEGJËSIA SOCIALE



Eurosig i kushton përgjegjësisë sociale një vëmendje shumë të madhe. Falë angazhimit dhe kujdesit të vazhdueshëm të Presidentit, z. Kadri Morinaj, Eurosig ka angazhuar burime njerëzore dhe financiare, të cilat janë në dispozicion të drejtpërdrejtë të shoqërisë dhe mejdisit ku Eurosig ushtron veprimtarinë e saj, por dhe më gjerë, mjedisit kulturor, artistik, mediatik etj.

Gjatë vitit 2017, Eurosig ka mbështetur financiarisht veprimtari të shumta kulturore dhe sportive, të cilat bëjnë të mundur pikërisht atë mbështetje, atë plotësim të atij dimensionit që biznese të mesme dhe të mëdha janë duke luajtur në drejtim të zhvillimit të artit, kulturës dhe sportit në vendin tonë dhe më gjerë. Një vëmendje të shtuar ka patur Eurosig edhe ndaj shtresave në nevojë.

Disa nga veprimtaritë e mbështetura financiarisht nga Eurosig gjatë vitit 2017 janë:

- ❖ Promovimi i vlerave artistike kombëtare shqiptare në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit në Shtutgart, Gjermani, ku Shqipëria kishte stendën e vet. Në këtë panair, ku mori pjesë dhe Presidenti i Grupit Eurosig, z. Kadri Morinaj, u prezantua dhe Kampionati i 9 Botëror i Fluturimeve me Paragliding në Precizion "Albania 2017", ku Eurosig dhe INSIG janë mbështetësit kryesor. Veprimtaritë u pasqyruan nga media ndërkombëtare.
- ❖ Mbështetje e "Judo for Peace", në Turneun Ndërkombëtar të Xhudos, i cili u mbajt në palestrën e sporteve "Karagaqi" në Pejë, prill 2017.
- ❖ Mbështetje e "9th FAI WORLD Paragliding Accuracy Championship Albania 2017". Për herë të parë, një kampionat botëror parashutizmi u zhvillua në Shqipëri me pilotë nga e gjithë bota.
- ❖ Mbështetje e sportistëve të Federatës Shqiptare të Aeronautikës për "Llogara Air Games", Kampionati i 7-të Kombëtar Shqipëri & Kosovë, me mbi 30 pjesëmarrës nga të gjitha trevat shqiptare.
- ❖ Mbështetje e parashutistëve shqiptarë në kampionatin "Pre European Slovenia 2017", duke promovuar vlerat shqiptare nëpër botë.
- ❖ Mbështetje për Turin e Shqipërisë me 150 çiklistë nga e gjithë Evropa, që të kishte një start sa më dinjitoz, duke qëndruar pranë sportistëve gjatë etapave që u zhvilluan në 5 ditë.
- ❖ Mbështetje e Edicionit të 55-të të Festivalit Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë 2017, i cili u zhvillua në qendër të qytetit të Shkodrës.
- ❖ Eurosig, partner zyrtar i Federatës Shqiptare të Peshëngritjes u kujdes për një film të mbarë të Kampionatit European të Peshëngritjes për të Rinj, tetor 2017.
- ❖ EUROSIG dhe INSIG, si kontribuues në rritjen ekonomike të vendit, mbështetën Konferencën e Tretë për Financën: Prioritetet e Ekonomisë Shqiptare në Kuadër të Integritetit Rajonal dhe Global.
- ❖ Presidenti i Eurosig Z. Kadri Morinaj, kontribui personalisht në hapjen e Ekspozitës së Pikturës "Albanian & German Colors", nga artisti shqiptar z. Muhamet Kërpaçi dhe artisti shqiptaro-gjerman z. Vullnet Muja.
- ❖ Mbështetje e këngëtarit Kozma Dushi për dhënien me sukses të koncertit "Nostalgjia", një shfaqje e gërshetuar me emra të tjerë të



mëdhenj të këngës shqiptare.

- ❖ Presidenti i Eurosigs, Z. Kadri Morinaj, ishte i ftuar në lançimin e Masterit për Sigurime në Kolegjin Universitar “Luarasi”, ku tregoi mbështetje jo vetëm për këtë universitet, por mundësoi edhe 20 bursa për studentët pjesëmarrës.
- ❖ Eurosigs u ofroi bursë të plotë për pagesën e shkollimit studentëve ekselentë të Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës.
- ❖ Eurosigs mori pjesë në veprimtaritë e zhvilluara në panairin e Punës dhe Karrierës të organizuara në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, në Universitetin Epoka, në Universitetin e Nju Jorkut në Tiranë dhe në Universitetin Europian të Tiranës. Në këto panaiere, pati një interesim të madh të studentëve dhe jo vetëm, të cilët vizituan stendën tonë.
- ❖ Eurosigs mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Universiteti i Nju Jorkut, në Tiranë, janar 2017.
- ❖ Biznesmeni i njohur shqiptar për bamirësinë e tij, z. Kadri Morinaj, dhe “Programi Shpresa” (Londër), organizuan mbledhjen festive të Vitit të Ri me fëmijët e pashoqëruar shqiptarë që kanë kohët e fundit në Britani, dhjetor 2017.
- ❖ Kompanitë EUROSIG & INSIG, të njohura në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, me moton “Gjithnjë pranë klientit, duke i takuar fizikisht ata!”, morën pjesë me sukses në panairin e përvitshëm “Klik Expo Group”, nëntor 2017. Punonjësit e kompanive prezantuan për vizitorët dhe të interesuarit informacionet e kërkuara.
- ❖ Për të tretin vit radhazi, në Qendrën Polivalente Ditore Kamëz, Grupi Eurosigs shtroi një drekë për të moshuarit që e frekuentojnë këtë qendër, dhjetor 2017.
- ❖ Me rastin e festës së 8 Marsit, nën kujdesin e Presidentit të Grupit Eurosigs, z. Kadri Morinaj, nënat dhe motrat e Bashkisë Fushë-Arrëz kaluan një drekë festive.



VEPRIMITARI TË STAFIT TË EUROSIG

- ❖ Stafi i shoqërive të Grupit Eurosig morën pjesë në trajnimin e radhës me ekspertët z. Maximilian Bauer dhe z. Matevž Rostaher. Presidenti i Grupit Eurosig z. Kadri Morinaj, beson dhe investon në kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve të kompanive të tij.
- ❖ “Një fundjavë së bashku, të qeshur dhe plot harmoni!” Ishte ky motivi i udhëtimit të organizuar nga EUROSIG dhe INSIG, nën kujdesin e Presidentit Morinaj, me stafin e të dy kompanive, në rrethin e Skraparit, ku një ndër atraksionet e tij janë kanionet.
- ❖ Stafi i femrave të EUROSIG dhe INSIG festuan 8 Marsin në Pogradec, me mbështetjen e dy kompanive të sigurimit.
- ❖ Shoqëritë e Grupit Eurosig festuan së bashku më madhështi festat e fundvitit në Hotel Tirana, ku ishin të pranishëm dhe personalitete të jetës politike, shoqërore dhe kulturore të Shqipërisë dhe Kosovës.



PROMOVIMI I VLERAVE TË EUROSIG, ÇMIME, VLERËSIME



Gjatë vitit 2017, presidenti i Eurosigs, zoti Kadri Morinaj, promovoi vlerat e shoqërive të Grupit Eurosigs në takimet me:

Gjatë vitit 2017, presidenti i Eurosigs, zoti Kadri Morinaj, promovoi vlerat e shoqërive të Grupit Eurosigs në takimet me:

- ❖ ministrin e Drejtësisë të shtetit Baden - Württemberg, Gjermani, janar 2017;
- ❖ drejtorin e Përgjithshëm të Panairit Ndërkombëtar të Shtutgardit, janar 2017;
- ❖ trajnerin e kombëtares shqiptare Gianni De Biasi, i cili u vlerësua nga Italia me "Urdhrin e Yllit të Italisë", shkurt 2017;
- ❖ kryetarin e Bashkisë së Shkupit, Maqedoni, Koçe Trajanovski, mars 2018;
- ❖ komunitetin e Startup Grind, një komunitet global, i dizenuar për të edukuar dhe frymëzuar të rinjtë anëmbanë botës me anë të historive inspiruese të sipërmarrësve më të suksesshëm, prill 2017;
- ❖ studentët e Fakultetit të Ekonomisë, në Ceremoninë e Diplomimit të tyre, qershor 2017;
- ❖ kryeministrin e Republikës së Maqedonisë, z. Zoran Zaev, në darkën e organizuar nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore, ku ishin prezent dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, z. Vasil Pilo dhe z. Rexhep Meidani, qershor 2017;
- ❖ biznesmenë të shumtë nga Kosova dhe Diaspora Shqiptare, pjesëmarrës në Forumin Ekonomik të Diasporës Shqiptare në Prishtinë, Kosovë, nëntor 2018;
- ❖ presidentin e Kosovës, z. Hashim Thaçi, në mbrëmjen Gala të Forumit Ekonomik të Diasporës Shqiptare në Prishtinë, nëntor 2018;
- ❖ pjesëmarrësit në Forumin Ekonomik të Diasporës, në Restorant "Piazza", në Tiranë,



me rastin e 105-vjetorit të Pavarësisë, nëntor 2017;

- ❖ presidentin e Nderit të Biznesmenëve Shqiptarë të Diasporës, z. Lazim Destani, së bashku me një grup biznesmenësh shqiptarë në diasporë, nëntor 2017;
- ❖ pjesëmarrësit në meshën e organizuar nga Dioqeza e kryeqytetit të Brazilit për nder të Z. Kadri Morinaj, i cilësuar si mik special i Papa Françeskut, në ceremoninë e zbulimit të pllakatës së përgatitur në Brazil për Statujën e Nënë Terezës, të mundësuar nga presidenti i Grupit Eurosigs, dhjetor 2017;
- ❖ pjesëmarrësit në Asamblenë Evropiane të Biznesit, në Samitin e Liderëve në Oxford, Angli, dhjetor 2017.



GJATË VITIT 2017, PRESIDENTI I GRUPIT EUROSIG, ZOTI KADRI MORINAJ, U NDERUAN ME:

- ❖ Çmimin “Kalorës i Artë i Ehlibetit” dhënë nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane me motivacionin “Si njeriu i suksesshëm i biznesit, familjar i mrekullueshëm që me përvullësinë e tij u shtrin dorën pa kursim njerëzve në nevojë”;
- ❖ titullin “Doctor Honoris Causa” dhënë nga Universiteti Amerikan UAC, School of Global Management dhe International Academy of Social Sciences, Florida, SHBA;
- ❖ çmimin “Diamond Price” në kategorinë e kompanive të sigurimeve, dhënë nga “Awards Business Trend Albania 2017”;
- ❖ çmimin “Sokrates”, dhënë për Grupin Eurosig në Samitin e Liderëve Botëror të Biznesit, në Oksford, me motivacion “Për arritje të jashtëzakonshme në fushën e biznesit”. Informacioni rreth Grupit Eurosig do të vendoset në Almanakun e Sokratit 2018, i cili do të publikohet në nëntor 2018 dhe do të prezantohet në Samitin e Liderëve Botëror, në Oksford.





GJATË VITIT 2017, EUROSIG U NDERUA ME KËTO ÇMIME DHE VLERËSIME:

- ❖ Çmimi prestigjioz ndërkombëtar “Superbrands 2017”, si një kompani lider në industrinë e sigurimeve, me rritje të shpejtë dhe investime të mëdha.
- ❖ Çmimi “Sipërmarrja më e Mirë” në fushën e sigurimeve, dhënë për Grupin Eurosig nga Asambleja Europiane e Biznesit, me qendër në Oskford të Londrës;
- ❖ “Pllakata e Mirënjohjes”, dhënë nga organizatorët e Kampionatit European të Peshëngritjes për të Rinj, e cila në ceremoninë e mbylljes iu dorëzua z. Kreshnik Morinaj.
- ❖ Pas një analize të mbi 2 500 kompanive në Europën Juglindore, Eurosig është renditur nga SeeNews në vend të 76-të, 13 vende më lart, krahasuar me një vit më parë.



PJESËMARRJET E EUROSIG NË KAPITALIN E SHOQËRIVE TË TJERA



Eurosig zotëron 100% të kapitalit të shoqërive të sigurimeve INSIG Jojeta-Shqipëri, EURO-SIG-Kosovë, EUROSIG-Maqedoni dhe Degës së INSIG-Kosovë.

Eurosig është pjesëmarrëse në kapitalin e shoqërisë INSIG-Jeta me 10% të kapitalit. Gjithashtu, aksionarët e Eurosig janë pjesëmarrës në kapitalin e shoqërive të tjera, si më poshtë:

Nr.	Aksionarët	Shoqëria	%
1.	Kadri Morinaj	Bar Restaurant "Piazza" sh.p.k.	100%
2.	Xhevdet Morina	"Alb Univers" sh.p.k.	100%
3.	"Euro - Alba Ea" sh.p.k	"Plus Communication" sh.a.	2,04%

LISTA E AKSIONARËVE TË EUROSIG ME PJESËMARRJE INFLUENCUESE TË KAPITALIT



Nr.	Aksionar influencues për vitin 2017	%
1.	Kadri Morinaj	70,74%

LISTA E ADMINISTRATORËVE TË EUROSIG



Administrator (Drejtor i Përgjithshëm) i EUROSIG është z. Xhevdet KOPANI, i cili nuk është pjesëmarrës në kapitalin e shoqërisë.

MONITORIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I RISKUT QË NDËRMERR EUROSIG



MENAXHIMI I RISKUT NË SHOQËRINË EUROSIG

Në zbatim të detyrimeve të akteve ligjore, rregullatore dhe akteve të brendshme, Eurosig ka implementuar një sistem të plotë të menaxhimit të riskut të shpërndarë në të gjitha nivelet e shoqërisë, në mënyrë që të mbështesin realizimin e objektivave strategjike dhe specifike.

Për rregullimin dhe normimin e punës së strukturave të Eurosig, në tërësi, si dhe në drejtim të pranimit dhe menaxhimit të riskut, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm kanë nxjerë një sërë aktesh të brendshme, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 52, datë 22.05.2015, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet e rregullatore në zbatim të tij.

Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Mbikëqyrës, Menaxhimi i Lartë, Menaxhimi Operacional dhe çdo punonjës ka të përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe kufizimet e autoritetit të tij në aktet e brendshme të Eurosig, në lidhje me riskun dhe menaxhimin e tij. Kjo siguron dhe lidhjen e nevojshme midis detyrave që ka çdo punonjës dhe mënyrës se si i kryejnë këto detyra.

Duke marrë në konsideratë madhësinë e veprimtarisë së shoqërisë, kompleksitetin e saj dhe profilin e riskut, Eurosig ka krijuar Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, punonjësit e së cilës janë trajnuar nga AMF dhe zotërojnë kapacitetet e duhura profesionale për menaxhimin e riskut në shoqërinë e sigurimit. Punonjësit e kësaj drejtorie kanë autoritet të plotë për marrjen e çdo informacioni të nevojshëm për ushtrimin e detyrave funksionale të

përcaktuara në aktet rregullatore dhe aktet e brendshme të Eurosig.

Gjithashtu, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në Eurosig, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, komunikon me Këshillin Mbikëqyrës dhe Komitetin e Auditimit & Menaxhimit të Riskut në lidhje me vlerësimin e ekspozimeve ndaj riskut dhe masat që duhen marrë për menaxhimin e tyre; vlerësimin e ndryshimit në profilin e riskut; vlerësimin e ngjarjeve të riskut, si dhe përcaktimin e veprimeve të përshtatshme për ndreqje të situatës.

Mbështetur në Strategjinë pesëvjeçare të Eurosig 2016 - 2020 dhe Plan Biznesin 2017, u miratua Strategjia për Menaxhimin e Riskut 2017, në të cilën u përcaktuan:

- ❖ sistemi, politika, dhe parimet e menaxhimit të riskut;
- ❖ procesi i menaxhimit të riskut:
 - vendosja e objektivave,
 - kategoritë e riskut,
 - oreksi i riskut,
 - tolerancat e riskut,
 - identifikimi i riskut,
 - vlerësimi i riskut,
 - trajtimi i riskut,
 - monitorimi i menaxhimit të riskut;
- ❖ përgjegjësitë për menaxhimin e riskut;
- ❖ strategjitë e menaxhimit të riskut dhe
- ❖ dokumentimi dhe raportimi i çdo faze dhe veprimi të procesit të menaxhimit të riskut.

Eurosig aplikon metodologji dhe praktika bashkëkohore për identifikimin, klasifikimin (kategorizimin), vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve, në koherencë me kërkesat e AMF-së, të përcaktuara në manualin nr.132, datë 31.10.2014, “Mbikëqyrja me fokus riskun”.

Drejtoria për Menaxhimin e Riskut, në koordinim me strukturat qendrore dhe vendore të Eurosig, çdo vit identifikojnë risqet ndaj të cilave është e ekspozuar veprimtaria e Eurosig dhe që përbëjnë kërcënim për realizimin e objektivave strategjike dhe specifike të shoqërisë. Këto risqe klasifikohen në shtatë kategoritë kryesore, si më poshtë:

1. Risku i Kreditit,
2. Risku i Tregut,
 - 2.1 Risku i Normës së Interesit,
 - 2.2 Risku i Këmbimit të Monedhës së Huaj,
3. Risku i Sigurimit,
 - 3.1 Risku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosjes së Çmimit,
 - 3.2 Risku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësi,
4. Risku Operacional,
5. Risku i Likuiditetit,
6. Risku Ligjor dhe Rregullator,
7. Risku Strategjik.

Bazuar dhe në vlerësime sasiore, sipas linjave të biznesit, në përfundim të procesit, bëhet një vlerësim cilësor i risqeve, duke i kategorizuar si **I ulët, Mesatar** ose **I lartë**.

Procesi vjetor i Menaxhimit të Riskut në Eurosig u finalizua me Raportin e Vetëvlerësimit të Riskut dhe Aftësisë Pague (nr. 4156, datë 24. 05. 2018). Për hartimin e këtij Raporti përdoren teknikat analitike: analiza PESTEL, analiza SWOT, analiza e linjave të biznesit, analiza krahasuese e të dhënave, analiza e riskut etj. Versioni i plotë i Raportit, i klasifikuar “Sekret tregtar”, u vihet në dispozicion Presidentit, Këshillit Mbikëqyrës, Komitetit të Auditimit & Menaxhimit të Riskut dhe Menaxhimit të Lartë të Eurosig, kurse versioni i redaktuar u vihet në dispozicion Menaxhimit Operacional të Eurosig.

Njëkohësisht është hartuar dhe Raporti Vjetor mbi Vlerësimin e Risqeve në Eurosig, i cili u dërgua në AMF me shkresën nr. 4281, datë 29. 05. 2018.

MENAXHIMI I RISKUT NË GRUPIN EUROSIG

Për menaxhimin e riskut në subjektet e Grupit Eurosig zbatohen kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe rregullatore përkatëse në Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Rregulla dhe procedura më specifike janë përcaktuar në aktet e brendshme të Grupit Eurosig dhe subjekteve përbërëse të grupit.

Në vendimin e Asamblesë së Aksionarëve nr. 15, datë 13. 11. 2017, “Për krijimin e Grupit Eurosig”, është përcaktuar që:

- a) Kompetencat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Aksionarëve në nivel Grupi Eurosig ushtrohen nga Asambleja e Aksionarëve të Eurosig Shqipëri.
- b) Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës në nivel Grupi Eurosig ushtrohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Eurosig Shqipëri.
- c) Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komitetit të Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut në nivel Grupi Eurosig ushtrohen nga Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut i Eurosig Shqipëri.
- d) Përgjegjësitë e Auditorit të Jashtëm në nivel Grupi Eurosig ushtrohen nga Auditori i Jashtëm i Eurosig Shqipëri.

Po kështu, për mirëqeverisjen në nivel Grupi janë krijuar dhe:

a) Bordi i Drejtorëve të Grupit Eurosig me këtë përbërje:

- ❖ Drejtori i Eurosig Shqipëri – Kryetar Bordi/Drejtor Ekzekutiv i Grupit Eurosig
- ❖ Drejtori i Eurosig Kosovë – anëtar
- ❖ Drejtori i Eurosig Maqedoni e Veriut – anëtar
- ❖ Drejtori i INSIG Shqipëri – anëtar
- ❖ Drejtori i INSIG Kosovë – anëtar.
- ❖ Drejtori i Departamentit të Kontrollit dhe Koordinimit – anëtar.

b) Departamenti i Kontrollit dhe Koordinimit me këtë përbërje:

- ❖ Drejtori i Departamentit të Kontrollit dhe Koordinimit,
- ❖ Koordinatori për Grupin Eurosig,
- ❖ Auditori i Brendshëm për Grupin Eurosig,
- ❖ Drejtori i Menaxhimit të Riskut për Grupin Eurosig,
- ❖ Aktuari për Grupin Eurosig,
- ❖ Drejtori i Pajtueshmërisë për Grupin Eurosig,

- ❖ Drejtori i Koordinimit dhe Raportimit Financiar për Grupin Eurosig dhe
- ❖ Drejtori për Marrjen në Sigurim dhe Risigurimin për Grupin Eurosig.

Personat përgjegjës që mbulojnë këto funksione janë emëruar në mbledhjen e datës 23 maj 2018 të Këshillit Mbikëqyrës, të Grupit Eurosig.

Rregulla, procedura dhe metodologji për menaxhimin e riskut në Grupin Eurosig janë përcaktuar në pjesën e dytë të “Strategjisë për Menaxhimin e Riskut në Shoqërinë Eurosig dhe Grupin Eurosig për Vitin 2018.

RAPORTI I AUDITIT TË BRENDSHËM



BAZA LIGJORE

Auditimi i brendshëm për vitin 2017 në shoqërinë e sigurimeve “Eurosig sha” është zhvilluar në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe në zbatim të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, rregullores nr. 153, datë 23.12.2014, “Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit”, rregullores nr. 7, datë 30.01.2015 “Për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në Shoqërinë Eurosig sha” dhe “Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm” të shoqërisë.

ORGANIZIMI

• Misioni

- ❖ Kryerja e auditimit të brendshëm në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, standartet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranura për t’u zbatuar në Republikën e

Shqipërisë, si dhe programeve strategjike dhe vjetore të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

- ❖ Identifikimi dhe vlerësimi i riskut. Dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut.
- ❖ Kryerja e një veprimtarie të pavarur auditimi, për të dhënë siguri objektive menaxhimit dhe këshilluar drejtimin për përdorimin efektiv të burimeve, duke ndihmuar në mënyrë sistematike dhe të programuar në përmirësimin e efikasitetit, menaxhimit të riskut, sistemeve të kontrollit dhe proceseve të drejtimit. Si një proces dhe veprimtari e pavarur nga pikëpamja funksionale, vlerëson funksionimin e menaxhimit financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm. Në përfundim të procesit të auditimit jepen rekomandime dhe propozohen masa, për të përmirësuar funksionimin dhe drejtimin e subjekteve të audituara.

• Struktura dhe organizimi i NJAB

Njësia e Auditimit të Brendshëm është pjesë e strukturës organizative të kompanisë dhe

ka varësi organizative dhe funksionale nga Këshilli Mbikëqyrës. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i kësaj njësie rregullohet me Rregulloren “Për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në Shoqërinë Eurosig sha” miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me nr. 7, datë 30.01.2015.

Struktura është e organizuar me 1 (një) drejtues dhe 1 (një) auditues.

Gjatë periudhës së raportimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka kryer trajnime lidhur me “Funksionimin e Sistemeve të Informacionit të Kompanive të Sigurimit”.

Buxheti që i është vënë në dispozicion njësisë ka mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme dhe ka qënë i mjaftueshëm për realizimin e aktivitetit të saj.

REZULTATE TË VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Në përputhje me objektivat e përcaktuara të auditimit, siç janë:

- dhënia e një sigurie të arsyeshme menaxhimit të shoqërisë, për përmirësimin e veprimtarisë së saj dhe frytshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm;
- përdorimi me efektivitet i burimeve njerëzore e financiare;
- mbështetja ligjore e veprimtarisë në të gjithë zinxhirin administrativ dhe operacional;
- mirëadministrimi i vlerave materiale e monetare;

si dhe në zbatim të Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2017, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka vendosur si objektiva kryesore:

- Mbikëqyrjen e realizimit të treguesve kryesorë dhe analizën e tyre.
- Mirëadministrimin e burimeve financiare të kompanisë.
- Realizimin e detyrave dhe të drejtave të personelit.

- Sistemin e evidentimit dhe raportimit të të dhënave nga njësitet vartëse.

Gjatë vitit 2017, angazhimet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm janë realizuar në masën 80%. Plani nuk është realizuar plotësisht, për shkak se gjatë vitit 2017 NJAB është përfshirë në grupin e auditimit të BSHS, në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Rekomandimet e lëna gjatë auditimit janë pranuar në masën 100% nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë dhe janë zbatuar në masën 70% nga strukturat përgjegjëse. 25% e rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2017 janë në proces zbatimi, pasi zbatimi i tyre është i shtrirë në kohë dhe 5% e rekomandimeve të lëna nuk janë zbatuar.

Në zbatim të Planit Vjetor të Auditimit 2017, janë kryer auditime përputhshmërie, për të cilat fushat dhe objektet e auditimit janë si më poshtë:

- Zbatueshmëria e ligjit dhe rregulloreve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- Zbatueshmëria e rregulloreve, udhëzimeve dhe urdhërave të shoqërisë.
- Rastet e sigurimit të objekteve në vlera të mëdha dhe risqe të larta. Procedura e marrjes në sigurim dhe zbatimi i kushteve të kontratës.
- Shpenzimet e marrjes në sigurim, efektiviteti i tyre, zbatimi i urdhërave dhe kriterëve për përcaktimin e masës së këtyre shpenzimeve.
- Rakordimi i të dhënave kontabël dhe primeve të arkëtuara me të dhënat nga rregjistrimi i policave të shitura.
- Administrimi i aseteve të shoqërisë në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në degët rajonale.
- Efektiviteti i punës së degëve dhe departamenteve përkatëse për realizimin e shitjeve.
- Organizimi dhe realizimi i detyrave në rrjetin e shitjes. Sistemi i punësimit dhe vlerësimit të punonjësve.
- Kontrolli dhe analiza e shpenzimeve administrative.

- Analiza e debi – kredive; puna që bëhet për evidentimin e saktë dhe uljen e detyrimeve debitore, ndjekjen e padive të regresit, zbatimin e vendimeve gjyqësore.
- Mbajtja e kontabilitetit; zbatimi i rregullave për mbajtjen e evidencës kontabël, raportimet statistikore dhe kontabël të treguesve financiarë.
- Administrimi i policave të sigurimit dhe vlerave materiale e monetare në qendër, degë dhe agjensi. Zbatimi i procedurave për ruajtjen dhe qarkullimin e tyre, hartimi i dokumenteve përkatës dhe zbatimi i kritereve ligjore.

GJETJET E AUDITIMIT

- Vlerësim mbi përputhshmërinë me rregullat e administrimit të rrezikut

Shoqëria Eurosiga sha gjatë vitit 2017 ka ndër-marrë hapa aktiv lidhur me hartimin e rregulloreve dhe përcaktimin e detyrave të strukturave përgjegjëse për identifikimin dhe menaxhimin e risqeve.

Drejtorja e Menaxhimit të Riskut ka vepruar në kuadër të rregullores së shoqërisë nr. 8, datë 26.09.2016 dhe Strategjisë për Menaxhimin e Riskut 2017, duke kryer vlerësime të detajuara të risqeve ndaj të cilave është e ekspozuar shoqëria gjatë vitit 2017.

Gjatë vitit 2017, kjo Drejtori ka kryer raporte periodike mbi monitorimin e riskut dhe janë hartuar dhe miratuar Plane masash, me qëllim reduktimin e risqeve të identifikuar, si dhe parandalimin e risqeve në të ardhmen.

- Organizimi dhe realizimi i detyrave në rrjetin e shitjes

Gjatë vitit 2017 është rishikuar rrjeti i shitjes dhe janë marrë masa për licensimin e agentëve, proces që vijon.

Duke qenë se Eurosiga ka një rrjet të madh shitjeje, duhet që çdo muaj të vlerësohet performanca e agentëve/specialistëve, të cilët trajtohen me pagë dhe qera, në mënyrë që të reduktohen shpenzimet e kompanisë për rastet e punonjësve/agentëve jo produktiv, pasi gjatë auditimeve janë konstatuar raste që agentët, vazhdojnë të trajtohen me pagë dhe/ose qera pavarësisht nivelit të shitjeve që realizojnë.

Gjatë vitit 2017, është konstatuar një përmirësim i veprimtarisë së degëve lidhur me realizimin e detyrave funksionale të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme. Është shtuar stafi në disa degë dhe është realizuar ndarja e detyrave, duke rritur dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Pavarësisht kërkesave dhe urdhërave të vazhdueshëm lidhur me hartimin, ruajtjen, administrimin, sistemimin dhe arkivimin e dokumenteve, edhe gjatë vitit 2017 janë konstatuar probleme. Dorëzimi i policave të shitura/dëmtuara/anulluara etj. nga agentët në degë dhe nga dega në Drejtorinë e Shitjes në disa raste bëhet pa u shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Kjo e ekspozon shoqërinë ndaj riskut që kontrollet e brendshme të mos jenë efektive, si dhe në rast të konstatimit të rasteve abuzive nga agentët është e pamundur ndjekja në rrugë ligjore.

Përgjithësisht, rekrutimi i agentëve është bërë me kontrata të rregullta duke përcaktuar të gjitha kriteret dhe detyrimet e agentit ndaj kompanisë. Janë konstatuar raste të shpërndarjes së policave agentëve/agjencive që aktivitetin e shitjes së policave të sigurimit e kanë si aktivitet dytësor, të cilët pa nënshkruar asnjë marrëveshje juridike shesin në emër të kompanisë, kundrejt komisioneve përkatëse dhe nuk mbajnë përgjegjësi për administrimin e policave. Kjo mënyrë funksionimi rrit mundësinë që kompania të jetë pre e mashtrimeve dhe abuzimeve të agentëve. Gjatë vitit 2017, janë konstatuar raste sporadike, pasi degët dhe kompania kanë marrë masa për licensimin e agentëve dhe hartimin e kontratave në çdo rast.

- Efektiviteti i punës së degëve dhe departamenteve përkatëse për realizimin e shitjeve

Gjatë vitit 2017, kompania ka pasur rritje të shitjeve në masën 1%. Pothuajse shumica e degëve rezultojnë me mosrealizim plani. Ky është një tregues që flet për jo efektivitet të punës së degëve dhe megjithëse në objektivat e kompanisë është përcaktuar "Fokusi në produktet vullnetare dhe rritja e nivelit të shitjeve të këtyre produkteve", pothuajse në shumicën e degëve nuk është realizuar objektivi i vendosur lidhur me produktet vullnetare.

Planet dhe objektivat e përcaktuara nuk shkojnë deri në nivelin e punonjësve/ agjentëve, si dhe nga vet degët nuk kryhen analiza të detajuara, lidhur me faktorët që kanë ndikuar në realizimin/tejkalimin apo mosrealizimin e planit, në të cilat të përcaktohen dhe rekomandime për përmirësimin e punës. Kjo mënyrë funksionimi e degëve nuk vë në pozita pune specialistët dhe agjentët e degëve, si dhe rrit mundësinë që kompania të mos identifikojë në kohë faktorët me impakt negativ apo pozitiv në realizimin e objektivave të vendosura.

- Kontrolli dhe analiza e shpenzimeve administrative të degëve

Gjatë vitit 2017, është konstatuar se përgjithësisht nuk janë tejkalluar limitet e shpenzimeve administrative të degëve. Në shumicën e rasteve rimbursimi i shpenzimeve të degëve është shoqëruar me dokumentacion justifikues të njohur ligjërisht. Limitimi i shpenzimeve dhe respektimi i tyre ka çuar në reduktimin e nivelit të shpenzimeve administrative.

Procedura e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve është përqendruar në Drejtorinë e Përgjithshme dhe është formalizuar. Në çdo rast blerjet kryhen duke zbatuar procedurat e përcaktuara në urdhërat e brendshme dhe shoqëro-

hen me dokumentacionin përkatës. Kjo ka çuar në reduktimin e riskut të humbjes së aktiveve dhe përzgjedhjen e furnitorëve të duhur, gjë e cila ka reduktuar dhe kostot e blerjeve.

- Procedura e marrjes në sigurim dhe zbatimi i kushteve të kontratave

Mosnjohja e produkteve, kryesisht atyre vullnetare, si dhe procedurave të anulimeve, dëmtimeve etj. nga ana e agjentëve dhe në disa raste dhe nga ana e specialistëve të degëve ka bërë që lëshimi i policave, kryesisht atyre vullnetare, të bëhet duke mos zbatuar procedurat e marrjes në sigurim dhe duke mos plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në "Manualin e Procedurave Standarde për Marrjen në Sigurim" të kompanisë. Anullimi, dëmtimi dhe lëshimi i dublikatave, në disa raste është bërë duke mos respektuar rregulloret dhe udhëzimet e kompanisë. Kjo rrit riskun e sigurimit, si dhe rrit riskun që kontrollet e brendshme të mos jenë efektive.

Rregulloret/udhëzimet/manualet e brendshme të shoqërisë lidhur me procesin e marrjes në sigurim dhe vlerësimin e risqeve duhen rishikuar dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që të zvogëlohet risku i sigurimit.

Primet e aplikuara krahasuar me primet e përcaktuara në manualin e shoqërisë në disa raste janë të nënvlerësuar, kjo është konstatuar pothuajse për shumicën e produkteve vullnetare. Për produktin Kasko dhe produktin e Shëndetit Vullnetar është konstatuar aplikimi i tarifave shumë të ulëta, kjo kryesisht për shkak të konkurrencës. Kjo e ekspozon shoqërinë ndaj riskut të sigurimit, si dhe ndikon në rezultatin teknik negativ të produkteve.

Është konstatuar se ka pasur shumë problematika në kushtet e kontratave të produktit të Shëndetit Vullnetar. Në bazë të kushteve të kontratave kompania merrte shumë risk përsipër me prime shumë të ulëta, gjë që ka ndikuar dhe në rezultatin e produktit.

Gjatë vitit 2017, janë rishikuar kushtet e kontratave të produktit të Shëndetit, tarifat e produkteve vullnetare, si dhe është bërë seleksionim i klientëve të këtyre produkteve, me qëllim që të reduktohet risku i kompanisë dhe të përmirësohet rezultati teknik i produkteve.

- Shpenzimet e marrjes në sigurim, efektiviteti i tyre, zbatimi i urdhrave dhe kriterëve për përcaktimin e masës së këtyre shpenzimeve

Gjatë vitit 2017, është konstatuar rritja e shpenzimeve të marrjes në sigurim (komisione dhe bonuse) krahasuar me vitet e mëparshme. Nëse krahasojmë rritjen e shpenzimeve të marrjes në sigurim me rritjen e nivelit të shitjeve, vërejmë se ka një disproporcion, pasi ritmi i rritjes së shpenzimeve të marrjes në sigurim është më i lartë se ritmi i rritjes së shitjeve, gjë që tregon se rritja e shpenzimeve të marrjes në sigurim nuk ka qënë shumë efektive. Aplikimi i komisioneve të larta ndikon në rezultatin teknik të produkteve.

Përsa i përket nivelit të komisioneve të aplikuar, është konstatuar se përgjithësisht janë aplikuar komisione të miratuara nga strukturat përkatëse autorizuese. Në aktet e brendshme të kompanisë përcaktohet se në të gjitha rastet miratimi i komisioneve të veçanta (të ndryshme nga niveli i miratuar) duhet të merret me e-mail nga instancat përkatëse, por gjatë auditimeve është konstatuar se jo gjithmonë zbatohet ky rregull.

Në disa degë është konstatuar se shpërndarja e komisioneve/zbritjeve dhe bonuseve bëhet nga specialistët/drejtuesit e degëve, pa u shoqëruar me dokumentacion (bordero agjenti, mandat pagese etj.). Kjo rrit riskun që kontrolli i brendshëm të mos jenë efektive, si dhe nuk sigurohet informacion i saktë lidhur me përfituesit e komisioneve, gjë që mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të panevojshme, në rast se komisionet nuk përfitohen nga individët që sigurojnë klientë për kompaninë.

- Administrimi i policave të sigurimit dhe vlerave materiale e monetare në qendër, degë dhe agjensi. Zbatimi i procedurave për ruajtjen dhe qarkullimin e tyre, hartimi i dokumenteve përkatës dhe zbatimi i kriterëve ligjore

Vlerat materiale, përfshirë inventarin e imët, kancelaritë, paisjet e zyrave, materialet e konsumit etj., dokumentohen nëpërmjet fletë - hyrjeve të magazinës. Lëvizja dhe konsumi i tyre bëhet mbi bazë të nevojave, kërkesave dhe normave të konsumit. Dalja e tyre bëhet e autorizuar dhe e dokumentuar.

Shpërndarja e policave bëhet mbi bazën e kërkesës së degëve/agjentëve, duke marrë në konsideratë nevojën, shitjen dhe gjendjen aktuale të policave të sigurimit në degë/ agjentë. Në disa degë është konstatuar se shpërndarja e policave agjentëve bëhet pa u shoqëruar me fletë - dalje (përgjegjësi direkte e financierëve të degëve).

Marrja në dorëzim dhe shpërndarja e policave bëhet pa kontrolluar policat nëse ka ndonjë problematikë (lidhur me numrat serial, polica tepër, polica mangut etj.). Kjo vlen për të gjithë zinxhirin e shpërndarjes që nga specialisti i administrimit të policave, financierja e degës dhe agjenti ose specialisti i shitjes. Moskontrolli i policave gjatë realizimit të procesit të shpërndarjes dhe marrjes në dorëzim çon në mosevidentimin e problematikave në kohë dhe lindjen e mosmarëveshjeve ndërmjet punonjësve.

Është konstatuar në disa raste moszbatimi i rregullores lidhur me inventarizimin e policave (përgjegjësi direkte e drejtuesve dhe financierëve të degëve) dhe moszbatimi i rregullores që përcakton procedurën e kontrollit të kryerjes së inventarizimit nga degët (përgjegjësi e Drejtorisë së Shitjes). Kjo ka çuar në mosevidentimin në kohë të humbjes së policave, gjë që ekspozon shoqërinë ndaj riskut të mashtrimit nga ana e agjentëve.

- Kontrolli i shpenzimeve për përballimin e dëmeve, përlllogaritja e tyre dhe zbatimi i kriterëve ligjore dhe nënligjore

Gjatë vitit 2017, është kontrolluar struktura e trajtimit të Dëmeve të Shëndetit Vullnetar dhe ka rezultuar se jo gjithmonë është plotësuar dokumentacioni i nevojshëm për rimbursimin e shpenzimeve dhe, pavarësisht kësaj, dëmet janë rimbursuar nga kompania.

Janë konstatuar disa raste të rimbursimit të shpenzimeve në kundërshtim me kushtet e kontratave (p.sh. rimbursimi i skeletit të syzeve, shpenzime për medikamente të blera jashtë shtetit, shpenzime për medikamente pa recetë të mjekut etj.). Janë konstatuar raste të rimbursimit të vlerave më të larta për shkak të llogaritjes së gabuar të vlerave të dëmeve, të rimbursimit të dëmeve pa pasur rekomandim mjekësor.

Për shkak të kushteve të kontratave, ku nuk janë përcaktuar limite për raste specifike të sëmundjeve, si dhe mungesës së stafit të kualifikuar në fushën e mjekësisë, shpenzimet e dëmeve të shëndetit vullnetar kanë qënë në nivele të larta dhe disa kontrata të shëndetit vullnetar kanë rezultuar me humbje.

Gjatë vitit 2017, është ristrukturuar struktura e Marrjes në Sigurim të Shëndetit Vullnetar dhe është shtuar stafi i kualifikuar që merret me trajtimin e dëmeve të këtyre produkteve. Kjo ka çuar në menaxhimin e dëmeve dhe përmirësimin e rezultateve të kontratave dhe produktit në tërësi.

- Analiza e debi - kredive. Puna që bëhet për evidentimin e saktë dhe uljen e detyrimeve debitore

Shoqëria pasqyron në llogarinë "Klientë - degë" gjendjen debitore të specifikuar sipas degëve, por evidenca kontabël nuk siguron informacion për llogaritë e arkëtueshme sipas pro-

dukteve, për llojin e policës, numrin serial, datën e shitjes apo afatin e arkëtimit. Kjo ka bërë që për rastet e debitorëve të mbartur (para vitit 2015) të mos sigurohet informacion i plotë lidhur me debitorët, kryesisht për rastet kur nuk kanë informacion as degët. Me implementimin e sistemit të ri informatik, informacioni lidhur me shitjet dhe debitorët është i plotë.

Shoqëria përgjithësisht nuk lejon krijimin e debitorëve nga shitja e policave, pasi në rakordimet mujore me degët mbahen detyrimet e tyre, por gjendja debitore e lartë është kryesisht e mbartur nga vitet e mëparshme dhe i referohet agentëve/punonjësve të larguar, me të cilët kompania nuk ka më kontakt. Në disa raste është evidentuar mungesa e dokumentacionit të plotë lidhur me debitorët, prandaj dhe ndjekja në rrugë ligjore është e pamundur.

Mungesa e një metodologjie të duhur për vlerësimin e mundësive për të mbledhur llogaritë e arkëtueshme të vjetra mund të ndikojë mbivlerësimin ose nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Shoqëria pasqyron në llogarinë "Parapagime" paradhëniet që u jep agentëve/ specialistëve të shitjes për funksionimin e shitjeve nëpërmjet sistemit. Gjatë auditimeve janë evidentuar raste që agentët/punonjësit janë larguar pa mbyllur detyrimet me kompaninë. Duke qenë se këto paradhënie ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e aftësisë paguese të shoqërisë, janë marr masa nga kompania për të reduktuar nivelin e financimeve që iu jepen degëve.

Vlerësim mbi mjaftueshmërinë e sistemit të teknologjisë së informacionit, ruajtja dhe transferimi i të dhënave

Të dhënat e shitjeve nga Sistemi Sigurimi+ transferohen manualisht në Financa 5. Nuk është ndërtuar një proces automatik për transferimin e të dhënave. Transferimi manual i të dhënave ekspozon shoqërinë ndaj riskut të mashtrimit.

Përfshirja e përdoruesit në këtë proces sensitiv duhet të jetë vetëm për funksion kontrolli dhe jo përfshirje në të.

Të dhënat e dëmeve mbahen në format excel-i. Nuk ka një sistem të veçantë për regjistrimin e dëmeve, i cili të jetë i integruar dhe me sistemin financiar, në mënyrë që të dhënat të transferohen direkt, duke shmangur dhe riskun e gabimeve njerëzore dhe mashtimit.

Mbajtja e të dhënave në këtë mënyrë ka krijuar vështirësi në dhënien e informacionit dhe gjenerimin e raporteve në kohë. Mundësia e gabimit është e madhe, si dhe niveli i sigurisë së ruajtjes së të dhënave është i ulët.

Në vitin 2018 shoqëria ka implementuar sistemin e ri, në të cilin do jenë të integruar gjithë sistemet dhe është i pajisur me një sërë raportesh që lehtësojnë procedurat e marrjes në sigurim, mundëson gjenerimin e informacionit në kohë etj.

- Politika dhe manuale të shkruara për burimet njerëzore

Rekrutimi i punonjësve, në disa raste është bërë pa u trajnuar paraprakisht lidhur me pozicionin e punës dhe pa u njohur me detyrat e përgjegjësitë që pozicioni i punës përmban.

Gjatë auditimeve është konstatuar nevoja e punonjësve dhe agentëve për trajnime, kryesisht lidhur me njohjen e produkteve vullnetare, procedurave të marrjes në sigurim dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të kompanisë.

Në sektorin e Shëndetit Vullnetar trajtimi i rasteve të dëmeve është kryer nga persona jo të kualifikuar (pa background në fushën e mjekësisë), gjë që ka çuar dhe në rritjen e shpenzimeve të kompanisë si rezultat i rimbursimit të gabuar të dëmeve.

Gjatë vitit 2017, shoqëria ka organizuar trajnime të ndryshme nëpër rrethe dhe ka rekrutuar staf të ri, përgjithësisht me kualifikimin e duhur sipas pozicionit të punës.

- Vlerësim mbi mjaftueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm

Në përgjithësi baza e akteve të brendshme e hartuar nga kompania është në përputhje me ligjet dhe aktet rregullore përkatëse të hartuara nga AMF. Gjatë vitit 2017 janë hartuar dhe miratuar një sërë rregulloresh, udhëzimesh dhe urdhërash me qëllim që të arrihet përputhshmëria e plotë me bazën ligjore. Pavarësisht kësaj, gjatë auditimeve është konstatuar nevoja e hartimit dhe të disa rregulloreve shtesë me qëllim përmirësimin e aktivitetit të kompanisë, si dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si Rregullore për "Funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Shitjes dhe Administrimit e Produkteve Motorrike", "Menaxhimin dhe mbledhjen e debitorëve", "Funksionimin dhe organizimin e Sektorit të Shëndetit", "Procedurat e Marrjes në Sigurim për Produktin e Shëndetit Vullnetar", "Procedurat e trajtimit të dëmeve që vijnë nga produkti i shëndetit vullnetar", si dhe përditësimit të "Manualit të Marrjes në Sigurim", "Udhëzimit të Brendshëm të Produktit Kasko", "Marrëveshjeve me Bankat për shitjen e produkteve" etj.

Në përgjithësi ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm brenda departamenteve dhe njësive të audituara, si në drejtim të hartimit të procedurave, menaxhimit të shpenzimeve dhe administrimit të dokumentacionit. Janë kryer investigime, verifikime, vlerësime dhe kontrole paraprake të dokumentacionit justifikues. Ky sistem me procedurat dhe verifikimet përkatëse ka ndikuar në identifikimin, kontrollin dhe administrimin e risqeve që mbulojnë dhe menaxhojnë departamentet dhe njësitë e audituara.

Pavarësisht funksionimit të këtij sistemi gjatë auditimeve është konstatuar nevoja e disa ndryshimeve me qëllim forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm:

- ❖ Riorganizimi i Sektorit të Shëndetit, ndarja e strukturave të shitjes nga strukturat e trajtimit të dëmeve të shëndetit.

- ❖ Realizimi i procesit të kontrollit nga strukturat e brendshme sipas nivelit hierarkik të përcaktuar, si dhe vlerësimi i performancës dhe përcaktimi i penaliteteve për punonjësit që nuk realizojnë detyrat.
- ❖ Të rritet shkalla e komunikimit dhe raportimit të problematikave ndërmjet strukturave të brendshme të kompanisë, si dhe të formalizohet ky komunikim, me qëllim që të shmanget risku që kontrollet e brendshme të jenë jo efektive.

- Vlerësim mbi rregullsinë dhe saktësinë e raportimeve të depozituara në AMF.

Pasqyrimi i shitjeve në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe në AMF

Të dhënat lidhur me shitjet, anulimet, kthimet, dëmtimet e policave janë të pasqyruara saktë në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Procesi i rakordimit të të dhënave mes Drejtorisë së Shitjes dhe Drejtorisë së Financës është i formalizuar dhe nuk janë konstatuar diferenca mes raportimeve të dy drejtorive dhe raportimeve në AMF.

- Pasqyrimi i dëmeve të shëndetit vullnetar dhe raportimi i tyre në Departamentin e Dëmeve dhe AMF

Të dhënat lidhur me dosjet e dëmeve të shëndetit vullnetar mbahen në database në format excel-i, të cilat hidhen manualisht nga specialistët e sektorit të shëndetit. Në kontabilitet rregjistrimet kryhen nga specialistët e financës, duke hedhur manualisht të dhënat në programin financiar "Financa 5".

Nuk ka nje sistem të veçantë për rregjistrimin e dëmeve, i cili të jetë i integruar dhe me sistemin financiar, në mënyrë që të dhënat të transferohen direkt, duke shmangur dhe risqet e gabimeve njerëzore gjatë hedhjes së të dhënave.

Janë konstatuar raste të raportimit të ndryshëm ndërmjet Departamentit të Dëmeve dhe Sektorit të Shëndetit, kjo për shkak të mospasqyrimit të informacionit të plotë dhe të saktë në database-in e shëndetit, por është bërë verifikimi i rasteve dhe raportimi në AMF është kryer i saktë.

REKOMANDIMET

- ❖ Të përcaktohen objektiva të qarta dhe plane të të ardhurave deri në nivelin e agjentëve/punonjësve dhe të vlerësohet performanca e tyre nga ana e drejtuesve të degëve, drejtorive dhe departamenteve.
- ❖ Të realizohen analiza minimumi 3 mujore (të shkruara) nga ana e degëve, drejtorive dhe departamenteve ku të vlerësohet performanca e strukturës, të përcaktohen problematikat dhe të propozohen zgjidhje.
- ❖ Të hartohen strategji të qarta për zgjerimin e tregut të produkteve vullnetare.
- ❖ Drejtoria e Shitjes të kryejë funksionin e saj si hallkë kontrolli e veprimtarisë së degëve, të marrë masa dhe të zbatojë penalitetet e përcaktuara në rregulloret e brendshme të kompanisë ndaj çdo agjenti/punonjësi që nuk i zbaton ato dhe shpërdoron detyrën, si dhe të realizojnë kontrole tematike në vend për degët që kanë më shumë probleme.
- ❖ Të rishikohet niveli i shpenzimeve të marrjes në sigurim, në mënyrë që rritja e shpenzimeve të jetë efektive dhe të ndikojë në rritjen e shitjeve me një ritëm më të lartë se shpenzimet.
- ❖ Departamenti i Financës të mos lejojë krijimin e debitorëve nga shitja e policave dhe nga financimet, si dhe degët në bashkëpunim me financën të realizojnë mbylljen dhe sistemimin e gjendjes debitoare të tyre.
- ❖ Në çdo rast të mosarkëtimit të vlerave debitoare vullnetarisht, të merren masa për arkëtimin e shumave në rrugë ligjore.



- ❖ Të zbatohen procedurat e marrjes në sigurim, të plotësohen dosjet me dokumentacionin e përcaktuar në “Manualin e Procedurave Standarde për Marrjen në Sigurim”, si dhe specialistët që bëjnë mbylljet e degëve të kontrollojnë zbatueshmërinë e procedurave të marrjes në sigurim dhe plotësimin të dokumentacionit të përcaktuar në Manualin e Marrjes në Sigurim.
- ❖ Të rishikohet “Manuali i Marrjes në Sigurim” dhe të përditësohet me ndryshimet e reja.
- ❖ Të rishikohen kushtet e marrëveshjeve me bankat dhe subjektet dhe të nënshkruhen marrëveshjet e reja të përmirësuara, ku të parashikohen tarifat e aplikuara dhe komisionet që përfitojnë subjektet.
- ❖ Në mënyrë që të funksionojë sistemi i kontrollit të brendshëm dhe të realizohet menaxhim efektiv, duhen zbatuar rigorozisht procedurat e marrjes në sigurim, si dhe niveli i kompetencave të përcaktuara në udhëzimet e brendshme. Të kufizohet aksesin e degëve lidhur me aplikimin e tarifave në sistem, deri në nivelin e tarifave të miratuara. Për çdo rast të aplikimit të tarifave të ndryshme nga ato të miratuara, të merret miratim i shkruar nga instancat kompetente, si dhe të aplikohet në sistem nga specialistët e IT-së.
- ❖ Të implementohet një sistem, në të cilin të pasqyrohet informacioni i plotë lidhur me të dhënat e policave të shitura, dëmet, si dhe ky sistem të integrohet dhe me sistemin financiar, në mënyrë që të lehtësohet puna e specialistëve, të shmangen gabimet dhe informacioni të pasqyrohet në çdo kohë i plotë dhe i saktë. Kjo do ndikonte dhe në forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- ❖ Të rishikohen tarifat e produktit Kasko, në bashkëpunim me aktuarin e autorizuar të shoqërisë dhe të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.
- ❖ Të rishikohen kushtet e kontratave të shëndetit dhe të përcaktohen klauzola që limitojnë një sërë shërbimesh, si dhe në asnjë rast nuk duhet të bëhet rimbursimi i faturave pa dokumentacionin e plotë mjekësor.
- ❖ Duhet të shtohet staf i kualifikuar për marrjen në sigurim të klientëve dhe në çdo rast duhen zbatuar me përpikmëri procedurat e marrjes në sigurim (Vlerësimi i historikut të klientëve, përcaktimi i riskut dhe vendosja e çmimeve mbi bazën e riskut).
- ❖ Trajtimi i dosjeve të shëndetit duhet bërë nga staf i kualifikuar me background në fushën e mjekësisë.

- ❖ Të rritet shkalla e komunikimit dhe raportimit të problematikave ndërmjet strukturave të brendshme të kompanisë, si dhe të formalizohet komunikimi, në mënyrë që të përmirësohet aktiviteti i kompanisë dhe sistemi i kontrollit të brendshëm.
- ❖ Të përditësohen rregulloret e brendshme të kompanisë duke reflektuar ndryshimet e bëra, si dhe të hartohen rregullore të reja, në mënyrë që të ketë përputhshmëri të plotë me ligjet dhe rregulloret ekzistuese.
- ❖ Të përcaktohen nevojat për trajnime dhe të realizohen trajnime të vazhdueshme me qëllim kualifikimin e stafit dhe përmirësimin e veprimtarisë së kompanisë.
- ❖ Të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të plotë gjatë rakordimit të degëve me agjentët, si dhe strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme me degët.

PAVARËSIA

Ky raport auditimi i brendshëm u hartua në zbatim të kërkesave të nenit 122 të Ligjit nr. 52, datë 22. 05. 2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Gjatë kryerjes së auditimeve nuk ka pasur asnjë rast të cenimit të pavarësisë së audituesve.

PRIORITETET PËR VITIN E ARDHSHEM

Për vitin 2018 janë planifikuar të kryhen 16 auditime përputhshmërie në departamentet dhe drejtoritë kryesore të kompanisë, objekt i të cilave do të jenë fushat e përcaktuara me risk më të lartë, si:

- ❖ Zbatueshmëria e ligjit dhe rregulloreve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- ❖ Zbatueshmëria e rregulloreve, udhëzimeve dhe urdhrave të kompanisë.
- ❖ Rastet e sigurimit të objekteve në vlera

të mëdha dhe risqe të larta. Procedura e marrjes në sigurim dhe zbatimi i kushteve të kontratës.

- ❖ Aktiviteti risigurues.
- ❖ Shpenzimet e marrjes në sigurim, efektiviteti i tyre, zbatimi i urdhrave dhe kriterëve për përcaktimin e masës së këtyre shpenzimeve.
- ❖ Rakordimi i të dhënave kontabël dhe primeve të arkëtuara me të dhënat nga regjistrimi i policave të shitura.
- ❖ Administrimi i aseteve të shoqërisë në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në degët vendore.
- ❖ Efektiviteti i punës së degëve dhe departamenteve përkatëse për realizimin e shitjeve.
- ❖ Organizimi dhe realizimi i detyrave në rrjetin e shitjes. Sistemi i punësimit dhe vlerësimit të punonjësve.
- ❖ Kontrolli dhe analiza e shpenzimeve administrative.
- ❖ Analiza e debi - kredive. Puna që bëhet për evidentimin e saktë dhe uljen e detyrimeve debitore, ndjekjen e padive të regresit, zbatimin e vendimeve gjyqësore.
- ❖ Mbajtja e kontabilitetit. Zbatimi i rregullave për mbajtjen e evidencës kontabël, raportimet statistikore dhe kontabël të treguesve finaciare.
- ❖ Administrimi i policave të sigurimit dhe vlerave materiale e monetare në qendër, degë dhe agjenci. Zbatimi i procedurave për ruajtjen dhe qarkullimin e tyre, hartimi i dokumenteve përkatës dhe zbatimi i kriterëve ligjore.
- ❖ Kontrolli i shpenzimeve për përballimin e dëmeve, përlllogaritja e tyre dhe zbatimi i kriterëve ligjore dhe nënligjore.
- ❖ Vlerësimi i mjaftueshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, identifikimi dhe menaxhimi i risqeve.

Për realizimin e auditimeve do të angazhohen 2 punonjës (me kohë të plotë) të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, puna e të cilëve konsiderohet e mjaftueshme.

TREGUESI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT, TREGUESI I LIKUIDITETIT DHE TREGUESI I AKTIVEVE NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE



Vlerat e Treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, Treguesit të likuiditetit dhe Treguesit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike mund t'i konsultoni në Raportin e shoqërisë audituese mbi pasqyrat financiare 2017 të shoqërisë, përgatitur sipas SNRF, pjesë e këtij raporti (pika 2.3).

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2018



Objektivat strategjike:

- 1) Rritja me 13%, krahasuar me vitin 2017, e volumit të primeve të shkruara bruto, duke garantuar rritje të kapitalit financiar, të performancës ekonomike, të aftësisë paguese, të rezervave, si dhe përsosur sistemin e kontrollit të brendshëm dhe sistemin e menaxhimit të riskut.
- 2) Në fundin e vitit 2018, raporti i volumit të primeve të shkruara bruto në sigurimin vullnetar me volumin e primeve të shkruara bruto në sigurimin e detyrueshëm motorrik të jetë në masën 35 % me 65 %.
- 3) Shpenzimet për vitin 2018 të mbahen në nivelin 83 % të të ardhurave.
- 4) Rritja e volumit të dëmeve të paguara duke synuar vlerësim të drejtë, pagesë të shpejtë, si dhe rritje deri në 27 % të raportit të volumit të dëmeve të paguara me volumin e primeve të shkruara bruto, deri në fund të vitit 2018.
- 5) Implementimi i moduleve të programit informatik të kompanisë EduSoft.
- 6) Projektimi dhe hedhja në treg e një produkti të ri ose e 2-3 paketave, brenda vitit 2018.
- 7) Futja e një produkti online brenda vitit 2018.
- 8) Mësimi i burimeve njerëzore, i kombinuar me trajnime të nivelit të mesëm operacional edhe jashtë Shqipërisë.
- 9) Vlerësim të drejtë, të shpejtë dhe pagesë të dëmit brenda gjysmës së kohës të përcaktuar në rregullore.
- 10) Ndjekja e një politikë konservative të shpenzimeve në tërësi, veçanërisht e shpenzimeve të përgjithshme.
- 11) Mësimi i një gjendjeje të shëndoshë financiare, duke siguruar një aftësi paguese të qëndrueshme, si dhe aktive të mjaftueshme në mbulim.
- 12) Forcimi i auditimit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm.

Objektivat specifike:

- 1) Segmentimi i klientëve, duke u përqendruar fort tek produktet vullnetare, nëpërmjet buri-

RAPORTI I AUDITUESIT TË JASHTËM NDËRKOMBËTAR, GRANT THORTON Sh.p.k., MBI PASQYRAT FINANCIARE TË GRUPIT SIPAS SNRF



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Eurosig sh.a

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017



Grant Thornton

Raporti i Audituesit të Pavarur

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frashëri, Kompleksi T.I.D, Shk. B
Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560
www.grantthornton.al

Për aksionarët dhe drejtimin e Grupit Eurosig Sh.a,

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëngjitur të Grupit Eurosig Sh.a dhe Shoqërive të Kontrolluara prej tij ("Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe të tjera shënime shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të përshkruara në seksion e raportit tonë *Bazat për Opinionin me Rezervë*, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të konsoliduar të Grupit me datën 31 dhjetor 2017, dhe performancën financiare të konsoliduar dhe flukset e parasë të konsoliduara për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin me Rezervë

1. Modifikime të opinionit në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara.

- 1.1 Pasqyra e pozicionit financiar të Grupit Eurosig Sh.a përfshin emrin e mirë (shënimi 18) të njohur në konsolidim për vlerën 753,917 mijë lekë, i cili përbëhet përkatësisht nga vlera prej 22,005 mijë lekë e emrit të mirë të njohur në konsolidimin e aktiveve neto në datën e blerjes të Shoqërisë së Kontrolluar Eurosig Sh.a në Kosovë dhe nga vlera prej 731,535 mijë lekë të njohur në konsolidimin e aktiveve neto në datën e blerjes të Shoqërisë së Kontrolluar Insig Sh.a. Insig Sh.a dhe Eurosig Sh.a raportojnë deficit në aftësinë paguese, gjë që tregon se ekzistojnë indikatorë për rënie në vlerë të emrit të mirë më 31 dhjetor 2017. Grupi nuk ka kryer ndonjë test për rënie në vlerë të emrit të mirë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016. Rrjedhimisht, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm për rënien në vlerë të emrit të mirë më 31 dhjetor 2017.
- 1.2 Grupi nuk ka kryer ndonjë vlerësim, në datën e blerjes, të aktiveve neto të Shoqërisë së Kontrolluar Insig Sh.a dhe Eurosig Sh.a në Kosovë si edhe në datën e shitjes së shoqërisë së kontrolluar Insig Jetë Sh.a. Rrjedhimisht, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm për vlerën e drejtë të aktive dhe detyrimeve të shoqërive të kontrolluara, të njohura në konsolidim më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.
- 1.3 Sikurse detajohet në shënimin shpjegues 3.5 *Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve*, rrethanat e përshkruara në paragrafet përkatëse të parimit të vijimësisë të Eurosig Sh.a në Shqipëri, Insig Sh.a në Shqipëri, Insig Sh.a në Kosovë, Eurosig AD dhe Eurosig Sh.a në Kosovë, tregojnë ekzistencën e një pasigurie materiale për vijimësinë e biznesit të Grupit. Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit nuk përfshijnë ndonjë korrigjim të mundshëm nga kjo pasiguri.

2. Modifikime të opinionit në lidhje me pasqyrat financiare të Shoqërisë mëmë Eurosigg Sh.a të cilat kanë efekt në pasqyrat e konsoliduara.

- 2.1 Pasqyra e pozicionit financiar të Shoqërisë mëmë përmban të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera në vlerë neto prej 222,404 (2016-267,427 mijë Lek) nga të cilat 60,164 (2016 - 81,694 mijë Lek) janë në vonesë mbi një vit dhe të pazhvlërësuar. Llogaritë në vonesë mbi një vit dhe të pazhvlërësuar Megjithëse ekzistojnë në dhëna objektive zhvlerësimi për këto teprica në datën e raportimit, Shoqëria nuk kreu çmuarje për zhvlerësim sipas kërkesave të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 39 Instrumentat Financiarë, Njohja dhe Matja. Rrjedhimisht, në mungesë të evidencës së përshtatshme të auditimit për rikuperimin dhe validitetin e primeve të arkëtueshme, ne nuk mund të përcaktojmë nëse kishte nevojë për rregullime të provizionit të të arkëtueshmeve nga sigurimi dhe të tjera më 31 dhjetor 2017.
- 2.2 Shoqëria mëmë ka blerë dhe më pas rivlerësuar ndërtesat gjatë vitit 2017. Vlera e drejtë dhe e rikuperueshme e ndërtesave është përcaktuar nga një vlerësues i jashtëm pronash i cili ka përdorur metodën e krahasimit për vlerësimin e ndërtesës. Ne nuk mund të merrnim evidenca të përshtatshme dhe të mjaftueshme për tu mbështetur në vlerësimin me bazën e krahasueshmërisë të kryer nga Shoqëria për përcaktimin e vlerës së drejtë të ndërtesave. Si rrjedhim, ne nuk mund të merrnim sigurinë e mjaftueshme dhe të duhur për të përcaktuar nëse ka nevojë për rregullime në lidhje me vlerën e rikuperueshme të investimeve në ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë Mëme dhe Grupit më 31 dhjetor 2017.
- 2.3 Sikurse përshkruhet në shënimin 37 e) Menaxhimi i rrezikut të kapitalit, më 31 dhjetor 2017 raporti i aftësisë paguese të Shoqërisë mëme duke përdorur metodën e kapitalit neto është në vlerë negative prej 366,184 mijë Lek, krahasuar me nivelin minimal pozitiv prej 574,927 mijë Lek të kërkuar të aftësisë paguese, sipas pikës 2 nenit 80 të ligjit të sigurimeve nr 52/2014. Gjithashtu, aktivet e lejuara në mbulim të rezervave teknike me 31 dhjetor 2017 ishin 67% e provigjoneve bruto krahasuar me një minimum prej 100% të kërkuar nga i njëjti ligj. Për më tepër, ka pasur kontestime nga Autoriteti Rregullator për llogaritjen e ketyre treguesve nga Shoqëria Mëme. Shoqëria mëmë nuk ka njohur ndonjë provizion lidhur me ndëshkimet që mund të ndodhin sa i përket mospërputhjeve me kërkesat rregullatore të lartpërmendura.
3. Modifikime të opinionit në lidhje me pasqyrat financiare të Shoqërisë së Kontrolluar Eurosigg Sh.a në Kosovë, të cilat kanë efekt në pasqyrat e konsoliduara.

- 3.1 Rregullatori i Shoqërisë së Kontrolluar Eurosigg Sh.a në Kosovë, Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"), përcakton dhe monitoron kërkesat e kapitalit të shoqërive të sigurimit në Kosovë. Rregullatori kërkon që Eurosigg Sh.a në Kosovë të mbajë kapitalin e saj bazë të paktën në vlerën përafërsisht prej 425,440 mijë Lek (3,200 mijë Euro). Shoqëria e kontrolluar Eurosigg Sh.a në Kosovë ka njohur fitim nga operacionet e saj për vitin 2017 në vlerë prej 170,209 mijë Lek (1,269 mijë Euro), rrjedha e pasasë nga aktivitetet operative është pozitive në shumën prej 55,693 mijë Lek (415 mijë Euro) si dhe nga data e periudhës raportuese humbja e akumuluar arrin në vlerën 1,770,446 mijë Lek (13,198 mijë Euro) (2016: 1,940,656 mijë Lek -14,466 mijë Euro). Si rezultat i kësaj, kapitali neto i Eurosigg Sh.a në Kosovë më 31 dhjetor 2017 është në vlerë negative prej 172,857 mijë Lek (1,300 mijë Euro) (2016: 341,545 mijë Lek -2,569 mijë Euro). Shoqëria e kontrolluar Eurosigg Sh.a në Kosovë nuk është në pajtim me minimumin e kapitalit sipas kërkesave për kapital të rregullatorit. Më 24 shkurt 2017, BQK morri vendimin për vendosjen e një administratori në Shoqërinë e kontrolluar Eurosigg Sh.a për një periudhë 6 mujore, me qëllim të rikuperimit të stabilitetit të pozicionit financiar të Shoqërisë. Pronari i Eurosigg Sh.a në Kosovë ka treguar gatishmëri dhe zotohet që të financojë Shoqërinë e kontrolluar Eurosigg Sh.a në Kosovë për një periudhë të parashikueshme në rast të ndonjë vështirësi financiare të saj. Këto kushte tregojnë se ekziston një pasiguri materiale për vijimësinë e biznesit të Eurosigg Sh.a në Kosovë. Pasqyrat financiare të Eurosigg Sh.a në Kosovë dhe ato të konsoliduara nuk përfshijnë ndonjë korrigjim të mundshëm nga këto pasiguri.

- 3.2 Pasqyra e Pozicionit financiar e Shoqërisë së Kontrolluar Eurosrig Sh.a në Kosovë përmban të arkëtueshmet nga sigurimet më 31 dhjetor 2017 në vlerën prej 243,901 mijë Lek (1,835 mijë Euro). Janë identifikuar disa të arkëtueshme në vonesë për më shumë se një vit për të cilat ekzistojnë të dhëna objektive për rënien në vlerë të tyre. Eurosrig Sh.a në Kosovë nuk ka bërë çmuarje për zhvlerësimin të arkëtueshmeve nga sigurimet siç kërkohet nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Si rrjedhojë, në mungesë të evidencës së përshtatshme të auditimit për rikuperimin dhe validitetin e primeve të arkëtueshme, ne nuk ishim në gjendje për të përcaktuar nëse ishte i nevojshëm ndonjë rregullim lidhur me këto vlera.
4. Modifikime të opinionit në lidhje me pasqyrat financiare të Shoqërisë së Kontrolluar Insig Sh.a. të cilat kanë efekt në pasqyrat e konsoliduara.
- 4.1 Shoqëria e kontrolluar Insig Sh.a ka rivlerësuar vlerën e drejtë për disa ndërtesa në vitin 2017. Vlera kontabël e këtyre pronave më 31 dhjetor 2017 është 52,106 mijë Lek. Vlera e drejtë dhe e rikuperueshme e investimeve në ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme është përcaktuar nga një vlerësues i jashtëm pronash i cili ka përdorur metodën e krahasimit për vlerësimin e ndërtesave. Ne nuk mund të merrnim evidenca të përshtatshme dhe të mjaftueshme për tu mbështetur në vlerësimin me bazën e krahasueshmërisë të kryer nga Shoqëria për përcaktimin e vlerës së drejtë dhe të rikuperueshme të ndërtesave. Për më tepër, IAS 16 Aktivitet Afatgjatë Materiale kërkon që nëse një apo disa aktive rivlerësohen, e gjithë kategoria e aktivitet/aktiveve rivlerësohet. Insig Sh.a nuk ka rivlerësuar të gjithë kategorinë e ndërtesave. Si rrjedhim, ne nuk mund të merrnim sigurinë e mjaftueshme dhe të duhur për të përcaktuar nëse ka nevojë për rregullime në lidhje me vlerën e drejtë dhe vlerën e rikuperueshme të aktiveve afatgjatë materiale në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë së kontrolluar Insig Sh.a dhe të Grupit si edhe për rezervën e rivlerësimit më 31 dhjetor 2017.
- 4.2 Shoqëria e kontrolluar Insig Sh.a ka llogaritur aftësinë paguese dhe aktivet e lejuara në mbulim të provigjioneve teknike. Më 31 dhjetor 2017, aftësia paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto është në vlerën negative prej 995,728 mijë Lek krahasuar me vlerën pozitive prej 370,000 mijë Lek të kërkuar sipas ligjit 52 datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, aktivet e lejuara në mbulim të provigjioneve teknike më 31 dhjetor 2017 ishin 38,26% (2016 - 68%) e provigjioneve teknike bruto krahasuar me një minimum prej 100% të kërkuar nga i njëjti ligj. Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria e kontrolluar Insig Sh.a ka përfshirë, në llogaritjen e aftësisë paguese, humbjet e mbartura të degës Insig Kosova, të cilat kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në llogaritjen e këtij treguesi. Humbjet e mbartura të degës Insig Kosova, mosarkëtimi i huasë nga Eurosrig Sh.a si edhe rritja e parapagimeve ndaj pronarit kanë ndikuar në përkeqësimin e treguesve rregullatorë. Rrethanat e përshkruara më sipër tregojnë ekzistencën e një pasigurie materiale që mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Insig Sh.a për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Shoqëria e kontrolluar Insig sh.a nuk ka njohur ndonjë provizion lidhur me ndëshkimet që mund të ndodhin sa i përket mospërputhjeve me kërkesat rregullatore të lartpërmendura.
5. Modifikime të opinionit në lidhje me pasqyrat financiare të Insig sh.a në Kosovë degë e Shoqërisë së Kontrolluar Insig sh.a në Shqipëri (‘Dega’), të cilat kanë efekt në pasqyrat e konsoliduara.
- 5.1 Detyrimet për humbjet dhe shpenzimet e rregullimeve të humbjeve të Insig sh.a në Kosovë më 31 dhjetor 2017 janë në vlerën prej 1,206,787 mijë Lek (9,077 mijë Euro). Gjatë procedurave tona të auditimit, ne kemi identifikuar se Dega nuk ka njohur në pasqyrat financiare detyrimet në lidhje me pagesat mujore të qirasë që rezultojnë nga vendimet ekzekutive të gjykatës për dëmet motorike ndaj palëve të treta. Përveç kësaj, Dega nuk ka kryer vlerësimin për të përcaktuar shumën e detyrimeve të panjohura për ato pagesa mujore të qirasë. Si pasojë, ne nuk ishim në gjendje të vlerësonim efektin e rregullimeve të mundshme në detyrimet për humbjet dhe shpenzimet e rregullimeve të humbjeve më 31 dhjetor 2017, si dhe humbjet dhe shpenzimet për rregullimin e humbjeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017.

- 5.2 Të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera të Insig Sh.a në Kosovë janë në vlerën prej 63,550 mijë Lek (478 mijë Euro). Në këto të arkëtueshme, përfshihen shuma në vonesë 3 muaj deri në 1 vit dhe më të vjetra se 1 vit respektivisht në vlerën 48,394 mijë Lek (364 mijë euro) dhe 2,659 mijë Lek (20 mijë euro), për të cilat Insig Sh.a në Kosovë nuk ka vlerësuar dhe njohur ndonjë provizion për zhvlerësim. Rrjedhimisht, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse ndonjë rregullim i këtyre të arkëtueshmeve ishte i nevojshëm më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017.
- 5.3 Sipas rregullores mbi llogaritjen e minimumit të aftësisë paguese, mjaftueshmërisë së kapitalit dhe fondit të garancisë për siguruesit jo-jetë të lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"), kapitali i siguruesve që ushtrojnë veprimtari me klasat e sigurimeve të jo-jetës dhe kapitalin e siguruesve që ushtrojnë veprimtari në fushën e risigurimeve nuk duhet të jenë më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese të siguruesve përafërsisht prej 425,440 mijë Lek (3,200 mijë euro). Më 31 dhjetor 2017, Dega ka një mungesë në aftësinë paguese në vlerë prej 1,017,599 mijë Lek (7,654 mijë euro) (31 dhjetor 2016: 9,670 mijë euro). Sipas rregullores për Investimin e aktiveve që mbulojnë provigjionet teknike dhe matematikore dhe investimin e kapitalit themeltar për siguruesit e lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"), të gjitha shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara të ruajnë aktivet që mbulojnë provigjionet teknike prej 70% më 31 dhjetor 2017. Më 31 dhjetor 2017, aktivet që mbulojnë provigjionet teknike rezultojnë në 493,643 mijë Lek (3,713 mijë euro), që përfaqëson 32% të provigjioneve teknike. Masat e mundshme, nëse ka, që mund të ndërmerren nga Banka Qendrore e Kosovës në lidhje me mospërputhjet e lartpërmendura me Ligjin, nuk mund të vlerësohen me siguri të arsyeshme që nga data e lëshimit të këtij raporti. Rrethanat e përshkruara më sipër tregojnë ekzistencën e një pasigurie materiale që mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Insig Sh.a në Kosovë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Aftësia e Insig Sh.a në Kosovë për të vazhduar në vijimësi varet nga mundësitë për të gjeneruar të ardhura, si dhe për mbështetjen nga aksioneri i saj. Aksioneri i Degës është i përkushtuar të vazhdojë mbështetjen e tij ndaj Degës. Gjatë vitit 2016, Dega ka përgatitur një plan rehabilitimi për 3 vitet 2017-2019 dhe ka marrë një miratim nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"). Sipas planit, pronarët e Degës kanë për qëllim të mbështesin Degën në të ardhmen e parashikueshme. Ata janë të detyruar të shtojnë minimum prej 4.7 milion euro kapital shtesë në një shumë prej 1.6 milion euro në vit për periudhën 2017-2019. Gjatë vitit 2017, pronarët e Degës kontribuan me një shumë prej 1,175 mijë euro.
6. Modifikime të opinionit në lidhje me pasqyrat financiare të Shoqërisë së Kontrolluar Eurosig AD në Maqedoni, të cilat kanë efekt në pasqyrat e konsoliduara.
- 6.1 Gjatë vitit 2017, Eurosig AD ka blerë tokë që nuk është përdorur për kryerjen e aktivitetit të sigurimit, në vlerë prej 250,349 mijë Lek (114,364 mijë denarë). Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, është identifikuar se çmimi për tokën e blerë është më i lartë se çmimet referuese të tregut në komunën ku është vendosur. Rrjedhimisht, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse kërkohet një korigjim i vlerës së regjistruar të tokës në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017. Për më tepër, blerja e kësaj toke ndikon në tejkalimin e kufirit prej 60% të kapitalit në pasuri të paluajtshme, si dhe investimet kapitale në shoqëritë e tjera të sigurimeve, institucionet financiare dhe subjektet e tjera juridike të siguruara sipas Nenit 73, paragrafi 2, pika 1, të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë. Më 31 dhjetor 2017, Eurosig AD ka investuar 76% të kapitalit në pasuri të paluajtshme.
- 6.2 Më 31 dhjetor 2017, llogaritë e arkëtueshme të Eurosig AD janë në vlerën prej 97,037 mijë Lek (44,328 mijë denarë). Rezultati i procedurave të kryera të verifikimit të pavarur të këtyre kërkesave, si dhe të procedurave të tjera të zbatuara të auditimit, nuk na lejon të marrim siguri të arsyeshme në lidhje me vlefshmërinë dhe saktësinë e shumës së regjistruar të llogarive të arkëtueshme të Eurosig AD më 31 dhjetor 2017. Përveç kësaj, një pjesë e këtyre llogarive të arkëtueshme, në vlerë prej 5,326 mijë Lek (2,433 mijë denarë), janë më të vjetra se një vit, çka përben një tregues për rënien në vlerë të mundshme të tyre. Eurosig AD nuk ka vlerësuar humbjet e mundshme, dhe nuk ka njohur ndonjë provizion për zhvlerësimin si pasojë e mos arkëtimit të shumës së lartpërmendur të llogarive të arkëtueshme në pasqyrat e saj financiare. Të dhënat dhe informacioni i disponueshëm nuk na lejojnë të përcaktojmë nëse nevojitet ndonjë rregullim i shumës së regjistruar të këtyre të arkëtueshmeve në datën e raportimit.

- 6.3 Më 31 dhjetor 2017, Eurosiga AD ka regjistruar të ardhura nga cështjet gjyqësore në proces, në një vlerë prej 30,777 mijë Lek (14,060 mijë denarë). Kjo nuk është në përputhje me kërkesat e SNRF-ve, sipas të cilave të ardhurat njihen vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të përfitohen nga entiteti. Ne nuk ishim në gjendje të siguronim të dhëna të përshtatshme për arsyeshmërinë dhe vlefshmërinë e të ardhurave të lartpërmendura.
- 6.4 Eurosiga AD ka njohur kostot e marrjes në sigurim në shumën totale prej 170,484 mijë Lek (78,822 mijë denarë). Të përfshira në këtë shumë janë edhe kostot e marketingut në shumën totale prej 33,253 mijë Lek (15,374 mijë denarë) të paguar për palët e lidhura. Një pjesë e këtyre shpenzimeve në shumën totale prej 6,651 mijë Lek (3,075 mijë denarë) kanë ndodhur në vitin e kaluar dhe njihen gjatë vitit 2017 gjë e cila nuk është në përputhje me kërkesat e SNRF. Rrjedhimisht, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017, shpenzimet e blerjes, si dhe humbja për vitin e përfunduar, kanë tejkaluar shumën me 6,651 mijë Lek (3,075 mijë denarë) dhe humbja e akumuluar është nënvlerësuar me 6,651 mijë Lek (3,075 mijë denarë).
- 6.5 Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, Eurosiga AD ka raportuar një humbje operative në vlerë prej 147,770 mijë Lek (68,320 mijë denarë) dhe 34,550 mijë Lek (15,974 mijë denarë) respektivisht. Më 31 dhjetor, 2017, kapitali i Eurosiga AD në bazë të llogaritjes së kapitalit sipas Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve në Republikën e Maqedonisë është në shumën prej 326,421 mijë lekë (149,115 mijë denarë) dhe nuk arrin të përmbushë minimumin ligjor prej 398,850 mijë Lek (3,000 mijë euro), siç parashikohet në Nenin 77 të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve në Republikën e Maqedonisë. Për më tepër korrigjimet e nevojshme të lartpërmenduar mund të ndikojnë në llogaritjen e kapitalit të Eurosiga AD më 31 dhjetor 2017.
- 6.6 Sipas nenit 86 të Ligjit mbi Mbikëqyrjen e Sigurimeve në Republikën e Maqedonisë, Eurosiga AD është e detyruar të investojë fonde të barabarta me vlerën e rezervave teknike. Më 31 dhjetor 2017, fondet e investuara për mbulimin e provigjoneve teknike janë më të ulëta se vlera e provigjoneve teknike prej 116,422 mijë Lek (53,183 mijë denarë).
- 6.7 Më 2 maj 2018, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Republikën e Maqedonisë i dorëzoi Urdhrin nr. UP1-08-2-66 Eurosiga AD, lidhur me procesverbalin e mbikëqyrjes të kryer ndaj kësaj të fundit më 13 shkurt 2018 sipas të cilit Eurosiga AD është e detyruar të paraqesë në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë një Raport për përmbushjen e detyrimeve ligjore, në përputhje me kërkesat e nenit 77 të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve në Republikën e Maqedonisë, i cili kërkon që kapitali të jetë në shumën e 'Fondit të Garancisë' jo më vonë se data 31 maj 2018. Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të Eurosiga AD në seancën e mbajtur më 15 maj 2018 miratoi një vendim për të rritur kapitalin e shoqërisë duke emetuar aksione të reja përmes një oferte private. Eurosiga AD do të rrisë kapitalin e saj duke emetuar 865 aksione të zakonshme me anë të një oferte private në shumën prej 115,002 mijë Lek (865 mijë euro) me kursin e këmbimit mesatar të Bankës Qëndrore të Republikës së Maqedonisë, të shpallur një ditë para vendimit për rritjen e kapitalit. Ndikimi i mundshëm në pozitën financiare të Eurosiga AD nga masat që Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve e Republikës së Maqedonisë do të ndërmerre për mospërmbushjen e afateve sipas kërkesave ligjore të Eurosiga AD nuk mund të përcaktohet me siguri të plotë në datën e lëshimit të këtij raporti. Kjo situatë tregon ekzistencën e pasigurisë materiale, e cila mund të krijojë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Eurosiga AD për të vazhduar në bazë të parimit të vijimësisë. Aftësia e shoqërisë së kontrolluar Eurosiga AD për të vazhduar aktivitetet e saj të biznesit në vijimësi do të varet kryesisht nga mbështetja e pronarit, si dhe në mundësinë e gjetjes së burimeve të vazhdueshme të financimit.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të Konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të Grupit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare individuale ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Grupi të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.
- marrim evidence të mjaftueshme të auditimit në lidhje me informacionin financiar të subjekteve ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe performancën e auditimit të Grupit. Ne jemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

11 qershor 2018

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar

	Shënimi	31 dhjetor 2017 (mijë lekë)	31 dhjetor 2016 (mijë lekë)
Aktivi			
Mjete monetare dhe ekuivalente	7	194,469	145,579
Depozita me afat	8	2,820,690	2,958,701
Aktive financiare të mbajtuara deri në maturim	9	112,912	1,403,493
Aktive financiare të mbajtuara për tregtim	10	104,198	23,022
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	11	663,107	624,951
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12	928,013	962,768
Pjesa e risiguruesit në provigjionet e kontratave të sigurimit	13	342,708	497,288
Te arkëtueshme nga risiguruesi	14	-	135,732
Aktive të tjera	15	1,080,532	837,681
Tituj kapitali	6	37,040	-
Te arkëtueshme për shitjen e Insig Jete sh.a	16	453,305	-
Aktive afat-gjata materiale	17	1,469,294	612,166
Aktive afat-gjata jomateriale dhe emri i mirë	18	764,486	766,775
Parapagime të tatimit mbi fitimin		-	58,201
Totali i aktivitet		8,970,754	9,026,357
Detyrime			
Provigjione për kontratat e sigurimit	19	6,746,263	7,901,806
Detyrime të qirasë financiare	20	29,007	30,973
Huatë	21	193,615	9,211
Llogari të pagueshme për sigurimin, risigurimin dhe të tjera	22	743,708	610,747
Provigjione të tjera		86,898	26,482
Detyrime tatimore aktuale		5,654	-
Tatimi i shtyrë		6,112	7,469
Totali i detyrimeve		7,811,257	8,586,688
Kapitali aksioner			
Kapitali aksioner	23	2,275,650	2,275,650
Rezerva të tjera	24	10,334	10,334
Rezervë rivlerësimi		289,499	-
Rezerva e kursit të këmbimit	25	7,027	12,138
Humbje të akumuluar	26	(1,423,013)	(1,858,453)
Totali i kapitalit aksioner		1,159,497	439,669
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner		8,970,754	9,026,357

Pasqyrat financiare të konsoliduara u miratuan nga bordi drejtues i Shoqërisë më 20 maj 2018, dhe janë firmosur në emër të tij nga:



Z. Xhevdet Kopani

Drejtore i Përgjithshëm

Zj. Anila Ibro

Drejtore i Departamentit Ekonomik

Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

	Shënimi	31 dhjetor 2017 (mijë lekë)	31 dhjetor 2016 (mijë lekë)
Primet e shkruara bruto	27	6,183,756	5,064,869
Primet e ceduara në risigurim	27	(412,360)	(460,198)
Taksa mbi primet		(110,307)	(96,702)
Primet e shkruara neto		5,661,089	4,507,969
Ndryshimi bruto në primet e pafituara	27	(156,266)	(377,424)
Ndryshimi bruto në primet e pafituara dhe në RBNS, pjesa e risiguruesit	27	39,942	8,717
Primet e fituara neto		5,544,765	4,139,262
Të ardhura të tjera	28	130,418	101,188
Të ardhura financiare	29	62,435	65,476
Shpenzime financiare	29	(11,435)	(3,597)
Të ardhura neto		5,726,183	4,302,329
Dëme dhe përfitime të shlyera	30	(2,841,908)	(1,639,533)
Ndryshimi në provigjonin e dëmeve	30	992,874	(1,108,964)
Rezultati pas dëmeve dhe përfitimeve të shlyera të polic-mbajtësve, neto		(1,849,034)	(2,748,497)
Kosto të marrjes në sigurim	31	(1,876,156)	(1,483,789)
Shpenzime administrative	32	(1,540,442)	(1,278,061)
Shpenzime të tjera operative	33	(91,821)	(66,350)
Provigjion për humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme nga sigurimi		(23,695)	(233,802)
Humbje nga kurset e kembimit	34	(36,611)	(3,000)
Fitimi nga shitja e Insig jeta Sh.a	6	128,744	-
Fitimi/(humbja) para tatimit		437,168	(1,511,170)
Tatimi mbi fitimin	35	(55,676)	(34,558)
Fitimi/(humbja) e vitit		381,492	(1,545,728)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		(5,111)	18,884
Të Ardhura/(humbje) gjithëpërfshirëse të vitit		376,381	(1,526,843)

Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksioner	Rezerva e rivlerësimit	Rezerve konvertimi	Rezerva të tjera	Humbje të akumuluar	Totali
Gjëndja më 1 janar 2016	592,050	-	(6,746)	10,334	(312,726)	282,912
Rezervë konvertimi	-	-	18,884	-	-	18,884
Rritje e kapitalit	1,683,600	-	-	-	-	1,683,600
Humbja e vitit					(1,545,727)	(1,545,727)
<i>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</i>	-	-	-	-	<i>(1,545,727)</i>	<i>(1,545,727)</i>
Gjëndja më 31 dhjetor 2016	2,275,650		12,138	10,334	(1,858,453)	439,669
Gjëndja më 1 janar 2017	2,275,650	-	12,138	10,334	(1,858,453)	439,669
Rezervë konvertimi	-	-	(5,111)	-	-	(5,111)
Rezerva e rivlerësimit	-	289,499	-	-	-	289,499
Rregullim për fitimin e mbartur të Insig Jeta më 1 janar 2017	-	-	-	-	16,645	16,645
Rregullimi për tatimin e fitimit Insig sh.a (shenimi 35)	-	-	-	-	37,303	37,303
Fitimi i vitit					381,492	381,492
<i>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</i>	-	-	-	-	<i>381,492</i>	<i>381,492</i>
Gjëndja më 31 dhjetor 2017	2,275,650	289,499	7,027	10,334	(1,423,013)	1,159,497

Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve të Parasë

	Shënimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi/(humbja) para tatimit		437,168	(1,511,169)
Amortizimi i aktiveve afat-gjata	17,18	76,877	64,140
Humbje nga zhvlerësimi	11	23,695	233,802
Rregullim i tatim fitimit Insig Sh.a	35	(37,303)	-
Rregullim për rivlerësimin e aktiveve		(31,766)	-
Rregullim për fitimin nga shitja e aktiveve neto të Insig Life	6	(128,744)	-
Të ardhura financiare dhe nga investimet	29	(62,435)	(65,476)
Shpenzime interesi	29	11,435	3,597
Rënie/(rritje) e pjesës së risiguruesit në provigjionet e kontratave të sigurimit		154,580	(343,011)
Rënie/(rritje) e të arkëtueshmeve nga risigurimi		135,732	(135,732)
Rritje në llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera të arkëtueshme		(8,747)	(310,800)
Rënie/(rritje) në koston e shtyrë të marrjes në sigurim		34,755	(485,366)
Rritje në aktive të tjera		(242,851)	(403,707)
(Rënie)/rritje në provigjionet e kontratave të sigurimit		(1,155,543)	5,064,110
Rritje në llogaritë e pagueshme për sigurimet, risigurimet dhe llogari të tjera		132,961	174,140
Rritje në provigjione të tjera		60,416	26,482
(Rënie)/rritje në rezervën nga përkthimi		(5,111)	19,334
Mjete monetare të (përdorura)/gjeneruara nga aktivitetet operative		(604,881)	2,330,344
Interes i paguar		(11,320)	(3,597)
Tatimi i paguar mbi fitimin		(29,124)	(82,913)
Flukset monetare neto të (përdorura)/gjeneruara nga aktivitetet operative		(645,325)	2,243,834
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese			
Te arkëtuara nga shitja e shoqërive të kontrolluara, neto nga fitimi nga shitja		(324,561)	-
Blerje e shoqërive të kontrolluara		-	(2,266,027)
Investime në tituj pronësie		37,040	-
Blerje të aktiveve afat-gjata materiale	17	(713,180)	(91,594)
Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale	18	(1,872)	(4,936)
Shitje aktiveve afat-gjata	17	104,099	961
Rënie/(rritje) në depozitat me afat		132,386	(145,212)
Aktive financiare të mbajtuara deri në maturim		1,290,581	(1,414,171)
Aktive financiare të mbajtuara për tregëtim		(81,176)	(23,024)
Interesa të arkëtuara		68,060	51,820
Mjete monetare neto përdorur nga aktivitete investuese		511,378	(3,892,183)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese			
Rritje të qirasë financiare		4,683	32,851
Shlyerje të qerasë financiare		(6,649)	(13,522)
Disbursime të kredisë bankare		202,500	-
Shlyerje për huatë e marra		(18,096)	(2,470)
Rritje në kapitalin aksioner		-	1,683,600
Flukse monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financuese		182,438	1,700,459
Rritja neto në mjetet monetare		48,490	52,110
Efekti i kurseve të këmbimit		400	(428)
Mjete monetare në fillim të vitit		145,579	93,897
Mjete monetare në fund të vitit	7	194,469	145,579

Shënimet për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

1. Informacion i Përgjithshëm

Eurosig Sh.a. ("Shoqëria"), shoqëria mëmë e Grupit, është shoqëri aksionare e themeluar në Shqipëri me vendodhje në Tiranë, rruga Papa Gjon Pali II. Eurosig Sh.a.. Shoqëria mëmë e Grupit, është subjekt i ligjit numër 52, datë 22 maj 2014, 'Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit'.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë mëmë të Grupit përfshin ofrimin e shërbimeve të sigurimit në aktivitetin Jo-Jetë për sigurimet motorrike, sigurimet e marinës, sigurimet e pronës, sigurimet e mallrave të transportit, sigurimet e ndërtimit, sigurimet e përgjegjëse civile dhe sigurimet e garancisë.

Shoqëria e Kontrolluar Eurosig sh.a. në Kosovë është e themeluar si Shoqëri Sigurimesh në aktivitetin e Jo – Jetës që nga i vitit 2000 fillimisht me emrin Dardania dhe duke filluar nga dhjetori i vitit 2015 doli në treg me emrin e ri Eurosig sh.a., tërësisht me kapital dhe aksionerë shqiptarë. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në bazë e në zbatim të ligjeve të aplikueshme në Kosovë dhe akteve të tjera normative të dala në zbatim të tyre, si dhe mbikëqyrjet nga Banka Qendrore e Kosovës, Departamenti për Mbikqyrjen e Sigurimeve. Eurosig sh.a., si Shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me 8 degë dhe mbi 62 zyra përfaqësimi.

Shoqëria e Kontrolluar INSIG Sh.a. është themeluar në 1991 si një shoqëri sigurimi në atë kohë 100% në pronësi të Qeverisë së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave. Aktiviteti kryesor i biznesit të saj përfshin sigurimin e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorrike, pronë, marinë dhe lloje të tjera sigurimi. Zyrat kryesore të INSIG sh.a janë Rruga "Jul Variboba", No. 21, Tiranë 1001 SHQIPERI.

Më 1 mars 2000 Insig Sh.a çeli një degë në Kosovë ("Dega"). Kjo degë ofron kryesisht sigurime të mjeteve motorrike dhe sigurim i palëve të treta në të gjithë territorin e Kosovës.

Më 8 mars 2003, Insig Sh.a filloi të operojë edhe në territorin Republikës të Maqedonisë nëpërmjet INSIG AD, Shkup e cila pas privatizimit të Insig Sh.a, Shqipëri ndyshoi emrin në Eurosig AD, Shkup ("Shoqëri e Kontrolluar"). Eurosig AD, Shkup është 100% në pronësi të INSIG Sh.a.

Më 23 mars 2016, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, "Eurosig "sha, u shpall fitues i procedurës së privatizimit të Insig sh.a. Më 1 qershor 2016, u nënshkrua marrëveshja e blerjes dhe u morrën aprovimet e nevojshme rregullatore dhe më 2 qershor 2016 u krye transferimi i aksioneve nga Ministria e Ekonomisë të Eurosig sh.a. si dhe u bë regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").

Grupi, me anë të vendimit të Aksionareve numër 16, datë 23 dhjetor 2016 vendosi:

- 1) miratimin e ndarjes së Shoqërisë Insig sh.a në dy Shoqëri: Insig sh.a (shoqëri sigurimi jo-jete) dhe Insig Jete sh.a.
- 2) miratimin e marrëveshjes së ndarjes së Shoqërisë Insig sh.a në dy shoqëri: Insig sh.a (shoqëri sigurimi jo-jete) dhe Insig Jete.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me anë të vendimit numër 202, datë 27 dhjetor 2016 miratoi e ndarjen e veprimtarisë së shoqërisë "Insig" sh.a. në shoqërinë e sigurimit "Insig" sh.a , e cila ushtron veprimtari për klasat e sigurimit të Jo-Jetes dhe në shoqërinë e sigurimit "Insig Jete" sh.a, e cila ushtron veprimtari për klasat e sigurimit të Jetës, efekte të cilat nisën prej 1 janar 2017.

Eurosig Sh.a me anë të kontratës së shitjes, datë 10 maj 2017, ka shitur 90% të aksioneve që zotëronte në Insig Jetë Sh.a, respektivisht në masën 45% të aksioneve Z. Samir Mane dhe 45% të aksioneve Z. Shefqet Kastrati për vlerën totale prej 473,305 mijë Lek (3,500,000 Euro). AMF me anë të vendimit numër 53 të Bordit, datë 22 maj 2017, vendosi miratimin e pjesëmarrjes influencuese në masën 45% të aksionarit Z. Samir Mane dhe 45% të aksionarit Z. Shefqet Kastrati, në shoqërinë e sigurimit të Jetës “Insig Jetë” sh.a., sipas kontratës së shitjes së aksioneve datë 10.05.2017.

Grupi operon në tregun e sigurimeve duke ofruar produkte sigurimi jo-jete në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës dhe Maqedonisë.

Struktura e aksionerëve të Shoqërisë mëmë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
	%	%
Z. Kadri Morina	70.74	70.74
Shoqëria “Euro-Alba.Ea” Sh.p.k	9.7	9.7
Z. Xhevdet Morina	19.22	19.22
Z. Ylli Merkaj	0.34	0.34
Totali	100.00	100.00

Asnjë nga Shoqëritë e Grupit nuk është e listuar në ndonjë bursë.

Drejtimi i Shoqërisë

Drejtimi i shoqërisë mëmë Eurosigs Sh.a në Shqipëri gjatë vitit 2017 deri në datën e nënshkrimit të këtij raporti përbëhet nga:

Z.Xhevdet Kopani
Zj.Anila Ibro

Znj. Akena Mema
Z.Qamil Sadikaj
Zj. Areta Çuko

Drejtor i Përgjithshëm
Drejtor i Departamentit Ekonomik
Drejtor i Departamentit të Marrjes në Sigurim e Risigurim dhe Marrëdhënieve me Jashtë
Drejtor i Departamentit të Dëmeve
Aktuar

Bordi Mbikqyrës

Bordi mbikqyrës i Shoqërisë gjatë vitit 2017 deri në datën e nënshkrimit të këtij raporti përbëhet nga:

Z. Vasil Pilo
Z. Skender Madani
Z. Rexhep Mejdani

Kryetar
Anëtar
Anëtar



RAPORTI VJETOR 2017

☎ +355 (0) 4 45 000 01/2

@ info@eurosig.al

🌐 eurosig.al

📍 Rr. Papa Gjon Pali II,
Vila nr. 5, Tiranë, Shqipëri